



Vlerësimi dhe
rekomandimet

RISHIKIMI I OECD-së MBI EVALUIMIN DHE NOTIMIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



Ky botim është përgatitur nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për nevojat e UNICEF-it dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Rishikimi është botuar nga UNICEF dhe të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale i përkasin OECD-së.



Vlerësimi dhe
rekomandimet

RISHIKIMI I OECD-së MBI EVALUIMIN DHE NOTIMIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



Përmbajtje

Parathënie.....	5
1. Hyrje.....	8
1.1. Trendet kryesore	10
1.2. Evaluimi dhe notimi në Maqedoninë e Veriut.....	18
2. Përmirësimi i rezultateve të mësimit përmes vlerësimit të nxënësve	24
3. Përdorimi i vlerësimit të arsimtarëve në mbështetjen dhe iniciimin e mësimdhënies së mirë.....	32
4. Ndërlidhja e evaluimit të shkollave me qëllimet e saja themelore të llogaridhënies dhe përmirësimit.....	40
5. Krijimi i kornizës më të fuqishme për monitorim dhe vlerësim të progresit nacional në arsim	48

Parathënie

Republika e Maqedonisë së Veriut ka arritur progres të shkëlqyeshëm në zgjerimin e qasjes në arsim dhe në fuqizimin e kapaciteteve institucionale. Megjithatë shumica e të rinjve të Maqedonisë së Veriut largohen nga shkolla ende pa i përvetësua kompetencat themelore të jetës dhe punës, ndërsa rrethi socio-ekonomik i nxënësve vazhdon të ndikojë në rezultatet e mësimit. Sektori i arsimit në Maqedoninë e Veriut ka nevojë për reforma të fuqishme dhe strategjike për përmirësimin e cilësisë dhe barazisë, ashtu që të gjithë të rinjtë në shtet ta arrijnë potencialin e plotë dhe t'i realizojnë aspiratat e tyre.

Ky rishikim është realizuar nga OECD-ja me mbështetjen e UNICEF-it dhe me kërkesë dhe bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Rishikimi i fokusuar në vlerësimin dhe evalumin e sistemeve shkollore kanë për qëllim ta ndihmojnë shtetin me rekomandime në kapitalizimin e praktikave pozitive dhe politikave, të cilat janë në funksion. Rishikimi në fjalë e inkurajon Maqedoninë e Veriut ta vë mësimin e fëmijëve në epiqendër të notimit dhe vlerësimit. Kjo do të nënkuptonte që të shkohet drejt një sistem, në të cilin notimi iu ofron informacione nxënësve, arsimtarëve, shkollave dhe hartuesve të politikave, me qëllim që të mund të reflektojnë në mënyrë kritike ndaj punës së tyre, por edhe të identifikojnë se çka mund të bëjnë më mirë në të ardhmen.


Rishikimi është zhvilluar në bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë për arsim dhe shkathtësi të OECD-së dhe UNICEF-it. Rishikimi ka përfituar nga përvoja komplementare e organizatës sonë dhe nga ekspertiza për të ofruar analiza të ndjeshme për kontekstin e evaluimit dhe vlerësimit (notimit) në sistemin arsimor të Maqedonisë së Veriut, por edhe duke i thirrur në hulumtime ndërkombëtare dhe praktika më të mira anekënd botës.

Mbi të gjitha, ne shpresojmë që ky rishikim do të jetë referencë e dobishme për Maqedoninë e Veriut pasi që e reformon sistemin e notimit dhe atë arsimor. Ky raport arrin në një moment të rëndësishëm për Maqedoninë e Veriut, pasi që e shqyrton mundësinë e zhvillimit të vlerësimit (notimit) të ri të nxënësve në nivel nacional. Rishikimi në fjalë diskuton shume opsione të politikave, të cilat zbatohen në vend, duke ofruar udhëzime të cilat do të mundësojnë vendimmarrje. Ne shpresojmë që rekomandimet e rishikimit do të kontribuojnë në zhvillimin e sistemit arsimor, i cili ofron përsosmëri për të gjithë.



Andreas SCHLEICHER

Drejtor për arsim dhe shkathtësi
dhe këshilltar i posaçëm për politika
arsimore të Sekretarit të përgjithshëm
të OECD-së



Benxhamin Perks

Përfaqësuesi i UNICEF-it
në Republikën e Maqedonisë së Veriut



VLERËSIMI DHE REKOMANDIMET





1. Hyrje



Për herë të fundit OECD-ja ka bërë rishikimin e politikave arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2003 (OECD, Reviews of National Policies for Education: South Eastern Europe 2003 : Volume 1: Albania, Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Kosovo, 2003). Brenda këtyre gjashtëmbëdhjetë viteve më shumë fëmijë dhe të rinj janë përfshirë në arsim dhe kanë ngel më gjatë në sistemin shkollor. Po ashtu nga viti 2003 e këndej ka pasur përmirësime të mëdha institucionale, siç është krijimi i agjencive të posaçme të qeverisë, të cilat tani e përqendrojnë kapacitetin profesional për funksionet kyçe të evaluimit dhe vlerësimit. Këtu është fjala për Qendrën Shtetërore të Provimeve (QSHP), e cila e menaxhon provimin e maturës shtetërore në nivel nacional, që njihet anekënd rajonit për karakterin e vetë inovativ dhe integritetin që posedon. Po ashtu këtu bën pjesë edhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), i cili e drejton dhe mbështet vlerësimin e rregullt të jashtëm dhe të brendshëm të shkollave në Maqedoninë e Veriut. Evaluimi i shkollave fokusohet në shumë aspekte të ambientit të shkollës, të cilat sipas hulumtimit konsiderohen qenësore për mësim. Megjithatë, përkundër këtyre përmirësimeve, ngel i kufizuar progresi në masat më të rëndësishme të cilësisë së sistemit arsimor, siç janë rezultatet mësimore të nxënësve.

Të dhënat nga Programi i OECD-së për Vlerësim Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) tregojnë se rezultatet e mësimin në Maqedoninë e Veriut janë më të ulëta sesa mesatarja ndërkombëtare ose rajonale, madje edhe nuk hasen shenja të përmirësimit.

Në vitin 2015 gjysma e personave 15 vjeçare në shtet nuk demonstruan aftësi themelore në të tre lëndët, në të cilat ishin vlerësuar: matematikë, lexim dhe shkencë (OECD, 2016). Mungesa e dukshme e përmirësimit të rezultateve mësimore të nxënësve ndodh në periudhën, kur është në rritje numri i nxënësve në Maqedoninë e Veriut, të cilët regjistrohen në arsimin terciar (sipëror), por që nuk reflektohen më pas në punësime. Kjo situatë imponon nevojën urgjente për të fuqizuar kornizën nacionale për evaluim dhe notim, me qëllim që mësimi i nxënësve të drejtohet dhe vlerësohet në bazë të standardeve nacionale më të rrepta dhe më relevante. Po ashtu kjo situatë e thekson nevojën për të siguruar që nxënësit me vështirësi në mësim të identifikohen më herët dhe të mbështeten në përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive themelore, të cilat do t'iu nevojiten për pjesëmarrje të plotë në zhvillimin e shtetit të tyre si ekonomi

konkurruese dhe anëtare e ardhme e Bashkimit Evropian.

Të vetëdijshëm për nevojën e fuqizimit të politikave të evaluimit dhe vlerësimit, Maqedonia e Veriut kërkoi nga OECD-ja dhe UNICEF-i të realizojnë një shqyrtim, i cili do të ofrojë rekomandime në tre sfera kryesore. Sfera e parë ka të bëjë me mënyrën e zhvillimit të sistemit nacional të vlerësimit, që do t'i mundësojë qeverisë t'i monitorojë rezultatet nacionale të mësimin dhe do ta mbështet përmirësimin udhëzues, duke iu shmangur shtrembërimeve, të cilat janë pasojë e modeleve paraprake të vlerësimit. Sfera e dyta ka të bëjë me ofrimin e udhëzimit për mënyrën e zhvillimit të mëtejme të provimit të maturës shtetërore, në veçanti nën prizmin e njohjes më të mirë dhe valorizimin e duhur të kompetencave të nxënësve shkollave të mesme të drejtimeve profesionale. Prioriteti i tretë ka të bëjë me mënyrën e krijimit të sistemit efektiv për arsimtarë profesionalë dhe për zhvillim të karrierës. Këto synime përputhen me qëllimet nacionale, të cilat janë të përcaktuara në strategjinë e re nacionale të arsimit (Tabela 0.1), e cila ishte publikuar, kur filloi ky rishikimi i realizuar nga OECD-ja dhe UNICEF-i.

Tabela 0.1.

Qëllimet arsimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në vitin 2018 Maqedonia e Veriut e nisi Strategjinë gjithëpërfshirëse arsimore për vitet 2018-2025. Strategjia në fjalë përfshin një sërë veprimesh relevante për vlerësimin dhe evaluimin e përmirësimit të arsimit, siç janë:

- ▶ Rritja e konsiderueshme e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor dhe zbatimi i shkollimit të detyrueshëm të edukimit para arsimit fillor (mosha 5-6).
- ▶ Reformimi i programit mësimor dhe programeve për arsim të detyrueshëm për rritje të rëndësishme dhe atraktivitetit të tyre, ndërlidhja më e mirë e tyre me shkallët e zhvillimit të fëmijëve dhe fokusi më i madh në rezultatet mësimore.
- ▶ Mbështetja e zhvillimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të librave cilësor shkollor, duke e reduktuar varësinë në tekstet shkollore për mësimdhënie.
- ▶ Orientimi më i mirë në programet e arsimit profesional dhe teknik (APT) drejt nevojave të tregut të punës.
- ▶ Fuqizimi i kompetencave të personelit mësimdhënës dhe të gjitha niveleve të arsimit.
- ▶ Fuqizimi i kapacitetit të menaxhmentit dhe lidhësive në nivelet qendrore dhe lokale të qeverisjes, por edhe brenda shkollave, si dhe sigurimi i politikave të harmonizuara dhe transparente.
- ▶ Zhvillimi i notimit nacional deri në vitin 2020 si dhe zhvillimi i konceptit të ri të maturës shtetërore, në veçanti për nxënësit e shkollave të mesme profesionale

Burimi: [MoES, 2018_[18]], *Strategjia gjithëpërfshirëse arsimore për vitet 2018-2025*, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shkup



1.1. Trendet kryesore:
Përkundër pjesëmarrjes së
fuqishme në arsim, rezultatet
mësimore nuk janë përmirësuar




Gjeneratat e reja dëshmojnë nivele të ngjashme të të arriturave në arsim sikurse bashkëmoshatarët e tyre në shtetet e OECD-së dhe BE-së

Pas një rënie në vitet pas pavarësisë së shtetit, pjesëmarrja në shkollim është zgjeruar në mënyrë të qëndrueshme (Grafiku 0.1). Kjo është pasqyruar në nivelet më të larta të të arriturave arsimore në mesin e gjeneratave më të reja në Maqedoninë e Veriut, ngjashëm me ato që hasen në shtetet e BE-së. Përderisa në vitin 2017, 38.3% të të rriturve (të moshës 45-64) e kanë braktisur shkollën pa e mbaruar arsimin e mesëm, vetëm 18% të të rinjve (të moshës 25-34 vjeçare) e kanë braktisur shkollimin e mesëm (ngjashëm me mesataren e BE-së, që është 16% për personat e moshës 25-34) (Eurostat, Database - Eurostat).



Edhe pse është përmirësuar pjesëmarrja në shkollë të mesme, regjistrimi i përgjithshëm në këtë nivel të arsimit ngel më shumë se 10 për qind sesa në shtetet tjera të rajonit, madje shumë më të ulët nga mesatarja e BE-së 119%. Regjistrimi është më i ulët te nxënësit me sfond të ulët socio-ekonomik dhe i atyre të mjediseve rurale. Arsyet për ndjekje të shkollimit në këtë nivel ndërlidhet me kushtet e dobëta të mësimin dhe pritjet e ulëta të familjeve dhe nxënësve (World Bank, North Macedonia: Public Finance Review, forthcoming).

Grafiku 0.1. Shkalla e përgjithshme e regjistrimit sipas shkallës së arsimit në Maqedoninë e Veriut (2000-2015)



Burimi: (UNESCO-UIS, The Republic of North Macedonia | UNESCO UIS) Republika e Maqedonisë së Veriut, UNESCO UIS, <http://uis.unesco.org/country/MK>.

Numri i universiteteve është rritur, por studentët kanë më pak gjasa të punësohen se sa kolegët e tyre në BE



Pjesëmarrja në arsimin sipëror është zgjeruar hovshëm në dy dekadat e fundit

Sistemi i arsimit sipëror në shtet është zgjeruar hovshëm në dy dekadat e fundit. Në vitin 2017 ka pasur 22 institucione të arsimit sipëror, për dallim nga vetëm 5 institucione të tilla në vitet 2003/2004 (UNESCO-IBE, 2011). Shtrirja e numrit të shkollave reflektohet në rritjen e regjistrimit, nga 15% në vitin 1991 deri në 40% në vitin 2015 (UNESCO-UIS, The Republic of North Macedonia | UNESCO UIS). Sidoqoftë rritja rapide nuk është shoqëruar me kontrollë të mjaftueshme të cilësisë. Ka përzgjedhje të vogël në programet studimore të arsimit sipëror. Të gjithë nxënësit, të cilët e kalojnë provimin e maturës shtetërore (të cilën në vitin 2017 e kanë kaluar 94.3% të nxënësve të gjimnazit) mund të regjistrohen në universitet, ndërsa kuotat shtetërore janë shumë të mëdha. Përhapja rapide e arsimit sipëror brenda periudhës kur suksesi i Maqedonisë së Veriut në vlerësimet ndërkombëtare ka ngelur shumë i ulët, sugjeron që shumë nxënës regjistrohen në universitet me boshllëqe të mëdha të dijes dhe shkathtësive të tyre, gjegjësisht pa lloje të

kompetencave të nivelit sipëror, të cilat nevojiten për përparim të suksesshëm në këtë nivel.

Po ashtu ekzistojnë shqetësime se programet terciare nuk i reflektojnë nevojat e tregut të punës. Personat e diplomuar kohëve të fundit nga arsimi sipëror në Maqedoninë e Veriut kanë shumë më pak gjasa të punësohen (55.4%) (Eurostat, Employment rates of recent graduates (aged 20–34) not in education and training, 2017, 2017) sesa personat që e mbarojnë arsimin sipëror në shtetet e BE-së (83%) (OECD, 2017). Shpjegim i kësaj është se personat e diplomuar në arsimin sipëror nuk posedojnë shkathtësi të mjaftueshme, ose shkathtësitë e tyre nuk përputhen me ato të tregut të punës. Një faktor, i cili kontribuon në dukurinë e dytë të sipërpërmendur është diversiteti i kufizuar në sigurimin e programeve të arsimit sipëror, në veçanti mundësitë e pakta në arsim sipëror teknik të cilësisë së lartë. Kjo gjendjen bën që shumë të diplomuar të arsimit të mesëm profesional të përcaktohen për drejtimet akademike në arsimin sipëror.

Rezultatet e mësimit janë ndër më të ulëtat në rajon dhe nuk përmirësohen


Në PISA 2015, personat e moshës 15 vjeçare të Maqedonisë së Veriut kanë arritur rezultate rreth katër vite prapa bashkëmoshatarëve të tyre të PISA-s. Mesatarja e tyre ka qenë 384 në shkencë, në krahasim me 493 të mesatares së shteteve të OECD-së (OECD, 2016). Vendi ka shënuar rezultate më të ulëta sesa shtetet fqinje, duke përfshirë Shqipërinë (427 pikë) dhe Malin e Zi (411 pikë), ndërsa rezultatet janë pak më të larta se të Kosovës (378 pikë) (OECD, 2016).

Rezultatet e vendit në vlerësimin ndërkombëtar gjithashtu paraqesin pak dëshmi për përmirësimin e arritur. Suksesi i leximit në PISA ka shënuar rënie për 21 pikë nga viti 2000 deri në vitin 2015 (Grafiku 0.2). Sa për krahasim, shteti fqinj i Shqipërisë ka shënuar rritje prej 56 pikë, ekuivalente me dy vite shkollë për periudhën e njëjtë.



Rezultatet në PISA për Maqedoninë e Veriut janë në rënie krahasuar me vendet fqinje


Grafiku 0.2. Suksesi i mesatares në leximit nga viti 2000 deri në vitin 2015



Vërejtje: Shqipëria ka marrë pjesë në PISA në vitet 2000, 2009, 2012 dhe 2015. Maqedonia e Veriut është përfshirë në PISA në vitet 2000 dhe 2015. Mali i Zi është përfshirë në PISA në vitet 2006, 2009, 2012 dhe 2015. Serbia ka marrë pjesë në PISA në vitet 2006, 2009 dhe 2012.

Burimi: (OECD, 2016), *PISA 2015 Rezultatet (Vëllime I): Suksesi dhe barazia në arsim*, OECD e publikuar në Paris, <http://dx.doi.org/10.1787/9789264266490-en>


Më shumë se tre nga pesë personat e moshës 15 vjeçare kanë mangësi themelore në lexim



Shqetësim i posaçëm në Maqedoninë në Veriut është përmasa e madhe dhe në rritje e sipër e nxënësve, të cilët nuk përvetësojnë shkathtësi themelore për matematikë dhe lexim. Nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse në PISA, Maqedonia e Veriut ka një pjesë të madhe të nxënësve (52.2%), të cilët kanë dështuar në demonstrimin e aftësisë themelore (niveli 2) të të tre fushave: shkencë, matematikë dhe lexim. Sidomos në rastin e leximit, më shumë se tre

nga pesë persona të moshës 15 vjeçare nuk kanë aftësi themelore për lexim (70.7%) siç vërtetohet matja e PISA-s. Në shtetet e OECD-së kjo mesatare është 20%, 50% në Shqipëri dhe 42% në Mal të Zi. Përderisa numri i personave me sukses të ulët ka shënuar rënie në pjesën më të madhe të rajonit, numri i personave me sukses të ulët në Maqedoninë e Veriut është rritur me pikë për rreth shtatë për qind nga viti 2000 deri në vitin 2015 (Grafiku 0.3) (OECD, 2016).

Grafiku 0.3. Ndryshimi i strukturës së personave me sukses të ulët në lexim për gjatë ciklit të PISA-s



Burimi: (OECD, 2016), *PISA 2015 Rezultatet (Vëllime I)*: Suksesi dhe barazia në arsim, OECD publikuar në Paris, <http://dx.doi.org/10.1787/9789264266490-en>

Shtetet fqinje arrijnë rezultatet më të mira me nivelin e njëjtë të shpenzimeve për arsim

Në 3.7% të BPV-së në vitin 2016, shpenzimet publike në arsim në Maqedoninë e Veriut janë më të ulëta sesa mesatarja e OECD-së (4.2% për BPV), madje ka shënuar rënie në vitet e fundit (World Bank, North Macedonia: Public Finance Review, forthcoming) (OECD, 2018). Nga viti 2011 deri në vitin

2016 shpenzimet publike për arsim në Maqedoninë e Veriut si përqindje e BPV-së ka rënë nga 4.6% në 3.7%. Po ashtu ka rënie në shumën e përgjithshme të shpenzimeve të qeverisë për arsim nga 13.3% në 11.6% (World Bank, North Macedonia: Public Finance Review, forthcoming).



Shteti po shpenzon më pak në arsim sesa mesatarja e OECD-së dhe kjo përqindje po zvogëlohet më tej

BPV

Maqedonia e Veriut

3.7%




4.6% OECD

Analiza krahasimtare sugjeron se përdërisa do të jetë e rëndësishme rritja e mjeteve financiare për përmirësim të rezultateve arsimore, ka hapësirë që Maqedonia e Veriut të arrijë rezultate më të mira me resurset, të cilat i investon (OECD, 2016). Shtetet fqinje kanë mund të arrijnë shkallë më të lartë të pjesëmarrjes dhe rezultate më të mira mësimorë me nivele të ngjashme ose të më të

ulëta të shpenzimeve në arsim (Grafiku 04). Kjo e vë në pah nevojën për më shumë vëmendje në efikasitetin dhe efektshmërinë e resurseve të ndara në Maqedonia e Veriut, në veçanti përpjekjet më të mëdha për zhvillim optimal të rrjetit shkollor, që karakterizohet me numër të madh të shkollave të vogla dhe proporcion të madh ndërmjet nxënësve dhe arsimtarëve.

Grafiku 04. Rezultatet e PISA-s 2015 dhe shpenzimet e qeverisë në shkollat e mesme

Suksesi në shkencë sipas PISA-s (pikët e fituara)




Burimi: (UNESCO-UIS, Education : *Initial government funding of education per student as a percentage of GDP per capita, 2018*), Arsimi: Financimi inicial i qeverisë i arsimit për nxënës si përqindje e BPV-së për kokë banori, UNESCO-UIS, <http://data.uis.unesco.org/>; (OECD, 2016), *PISA 2015 Rezultat (Vëllimi I): Suksesi dhe barazia në arsim*, OECD publikuar në Paris, <http://dx.doi.org/10.1787/9789264266490-en>.

Lokacioni i shkollave dhe gjuha e mësimdhënies janë fuqishëm të ndërlidhura me rezultatet

Rrethi socio-ekonomik i nxënësve nuk është aq fuqishëm i ndërlidhur me rezultatet mësimore në Maqedoninë e Veriut, për dallim nga shumë shtete të OECD-së siç matet nga PISA, pjesërisht për shkak se rezultatet hasen gjithandej të ulëta, dhe për shkak se disa grupe etnike - në veçanti popullata rome - kanë më pak gjasa të regjistrohen në shkollë në moshën 15 vjeçare. Megjithatë janë të mëdha dallimet e rezultateve të mësimin për nga vendndodhja e shkollave dhe grupet etnike. Maqedonia e Veriut ka hendek të madh të suksesit ndërmjet mjediseve urbane dhe rurale nga të gjitha strukturat pjesëmarrëse të PISA-s. Nxënësit e moshës pesëmbëdhjetë vjeçare të mjediseve rurale arrijnë 47 pikë më pak nga bashkëmoshatarët e tyre të mjediseve urbane në rezultatet e shkencës (në krahasim me diferencën e mesatares anekënd shteteve të OECD-së me 17 pikë). Ky hendek është i barabartë për rreth 1.5 vite shkollim (OECD, 2016).

Pjesëmarrja në arsim dhe rezultatet e mësimin nga grupet e komuniteteve etnike, në veçanti ato të bashkësisë shqiptare, janë gjithashtu dukshëm më të ulëta sesa ato të bashkësisë etnike maqedonase. Më shumë se gjysma e fëmijëve maqedonas kanë ndjekur edukim parashkollor në krahasim me më pak se një nga pesë fëmijë shqiptarë. Hendeku ndërmjet grupeve etnike bëhet më i theksuar, ashtu siç nxënësit arrijnë progres në sistem (USAID). Përderisa shqiptarët paraqesin rreth 25% të popullsisë së përgjithshme, ata përbëjnë vetëm 15.6% të nxënësve të shkollave të mesme dhe vetëm 5.5% të kandidatëve për regjistrim në arsimin sipëror (World Bank, North Macedonia: Public Finance Review, forthcoming). Në PISA 2015, nxënësit të cilët e kanë bërë provimin në gjuhën shqipe ishin më shumë se një vit mbrapa nga bashkëmoshatarët maqedonas, të cilët e morën provimin e shkencës në gjuhën maqedonase, edhe pas llogaritjes së rrethit socio-ekonomik (Grafiku 0.5).


Grafiku 0.5. Dallimet e suksesit të arritur në shkencë, në testin e gjuhës para dhe pas përllogaritjes së rrethit socio-ekonomik (PISA 2015)



Burimi: (OECD, 2016), *PISA 2015 Rezultatet (Vëllimi I): Suksesi dhe barazia në arsim*, OECD publikuar në Paris, <http://dx.doi.org/10.1787/9789264266490-en>



1.2. Evaluimi dhe notimi në Maqedoninë e Veriut



Ky shqyrtim analizon mënyrën sesi mund të përdoren politikat për vlerësim të mësimi të nxënësve, vlerësimin dhe mbështetje e arsimtarëve, evaluimin e shkollës dhe evaluimin e suksesit të sistemit arsimor në drejtim të përmirësimit të rezultateve të mësimi. Shqyrtimi mbështetet në analizën e OECD-së për politikat dhe praktikën për evaluim dhe notim në mbi 30 sisteme arsimore, si dhe në dëshminë e pasur që ka gjeneruar në faktorët që kanë të bëjnë me progresin në cilësinë e arsimit në kontekst të shteteve të ndryshme (OECD, 2013). Këndvështrimi i tillë krahasimtar zbulon tre çështje të ndërlidhura sistemore, të cilat do të jenë të rëndësishme për t'u adresuar, me qëllim që të mbështetet më mirë mësimi në Maqedoninë e Veriut.

Parashtrimi i qëllimeve për përmirësim të rezultateve mësimore dhe për matje të progresit

Në Maqedoninë e Veriut vërehet dukshëm mungesa e diskutimit në nivel nacional për qëllimet ose monitorimin e mësimi. Përderisa në nivelin më të lartë Strategjia e re gjithëpërfshirëse arsimore paraqet një hap përpara në më shumë aspekte, përcaktimi i veprimeve të rëndësishme, të cilat kanë përvetësuar mbështetje të përgjithshme nacionale nuk artikulon ndonjë qëllim nacional për përmirësim të rezultateve mësimore. Evaluimi në nivel të shkollës paraqet proces të çmuar, por si i tillë inkurajon shkollat të fokusohen në përputhje procedurale, e jo shqyrtim kritik për mënyrën sesi mjedisi i tyre mësimor i mbështet nxënësit t'i zhvillojnë dituritë dhe shkathtësitë e tyre. Asnjë shkollë e vizituar nga ekipi shqyrtues ekipet e OECD-së nuk ka potencuar se kanë ndonjë qëllim ose cak për përmirësim të rezultateve mësimore të nxënësve.



Sistemi arsimor nuk ka rezultate të qarta që synon të arrijë

Në nivel të klasës arsimtarët nuk kanë mjete të mjaftueshme, qoftë për sa u përket standardeve të mësimi të fokusuar në rezultatet ose vlerësimin e resurseve, që kanë të bëjnë me pritjet e programit mësimor me qëllim të detektimit dhe diagnostikimit të nevojave mësimore të nxënësve. Kjo bën që shumica e nxënësve të shkollave të kalojnë nga shkolla në shkollë pa mos përvetësuar kompetenca themelore. Intervistat e realizuara nga ekipi shqyrtues ekipet e OECD-së sugjerojnë që arsimtarët i përcaktojnë qëllimet për nxënësit e tyre në lidhje me përmbajtjen e diturisë që duhet përvetësuar, në vend se ta ndjekin përmirësimin e vazhdueshëm individual të nxënësit në lidhje me kompetencat më të gjera. Aktualisht evaluimi dhe vlerësimi synon të fokusohet në identifikimin e nxënësve me të arritura shumë të larta, atyre që do të jenë të mirë në gara akademike, "Olimpiada", gjegjësisht personave me vështirësi në mësim. Arsimtarët dhe shkollat nuk kanë vegla për vlerësim më të gjerë dhe më inkluziv të mësimi.

Në një shtet, në të cilin tre nga pesë persona të moshës 15 vjeçare nuk kanë shkathtësi themelore

për lexim ose shkathtësi numerike, përcaktimi i caqeve të thjeshta, të matshme, të cilat mund t'i kuptojë publiku, shkollat dhe arsimtarët, do të ofronte fokus themelor në përpjekjen për përmirësimin e rezultateve të mësimin. Ky shqyrtim ofron rekomandime për mënyrën sesi do të mund të zhvillohen standardet e mësimin, resurset e vlerësimit në klasë dhe vlerësimi i standardizuar nacional, me qëllim që t'iu ndihmohet arsimtarëve të bëjnë gjykimet të informuara profesionale, në lidhje me strategjitë për mësim të nxënësve dhe strategjitë për mësim efektiv. Këto mjete mund gjithashtu t'iu ndihmojnë shkollave, komunave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) t'i përcaktojnë dhe monitorojnë qëllimet e parashtruara, që të shpiket kah përmirësimi i mësimin. Komunikimi i këtyre qëllimeve dhe progresi në publik do të ndihmojë në krijimin e pritjeve nacionale dhe llogaridhënies për përmbushje të qëllimeve nacionale.

Fuqizimi i kompetencës nacionale

Maqedonia e Veriut posedon ekspertizë të fuqishme teknike në kuadër të agjencive të veta për evaluim dhe vlerësim – ISHA dhe QSHP si dhe Byroja për Zhvillim të Arsimit (BZHA). Sidoqoftë këto institucione nuk mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në zhvillimin dhe implementimin e politikave, për shkak se ato as nuk gëzojnë pavarësi në punën e tyre, e as nuk posedojnë resurse të duhura. Shumica e institucioneve kanë një numër të funksioneve kyçe, të cilat janë të zbrazët – për shembull, në kohën kur ekipi shqyrtues ekipi i OECD-së e vizitoi QSHP-në, aty nuk kishte drejtor dhe mungonte personeli psikometrik dhe ai i teknologjisë informatike. Po ashtu këto institucione nuk posedojnë mjetet e mjaftueshme financiare, si për shembull buxheti i BZHA-së nuk është adekuat për të siguruar gjashtëdhjetë orë zhvillim profesional të arsimtarëve, ndonëse pritet të ofrojë një gjë të tillë. Në kuadër të pushtetit qendror mungesa e personelit të dedikuar për hulumtim dhe mbështetja e kufizuar për menaxhim dhe analizë të të dhënave, për

shembull Sistemi për menaxhim të informacioneve arsimore në shtet (EMIS), i cili funksionon me vetëm dy anëtarë, bën që të kufizohet kapaciteti i Ministrisë për zhvillim të politikave të bazuara në dëshmi.



Shumë institucione arsimore nuk kanë staf në pozita kyçe

Ky shqyrtim rekomandon për mënyrën sesi duhet të fuqizohet kapaciteti i agjencive përgjegjëse për evaluim dhe notim, si dhe të mjeteve për ndërtim të kompetencave profesionale dhe pavarësisë. Institucionet kryesore në pushtetin qendror kanë nevojë për lider, i cili do të mund t'i prezantojë ato në nivel politik me mbështetje të fuqishme teknike. Po ashtu këto institucione kanë nevojë për resurse adekuate, në mënyrë që t'i përmbushin në mënyrë efektive funksionet e tyre qenësore dhe të kenë hapësirë financiare për identifikim dhe implementim të përmirësimeve të punës se tyre. Për shembull, të dhënat e QSHP-së për *maturën* do të përdoren për kuptim më të mirë të llojeve të çështjeve ose temave, të cilat nxënësit i konsiderojnë më të vështira, në mënyrë që të mund të ndihmohen arsimtarët, që t'ua mësojnë në të ardhmen ato tema në mënyrë më efektive.


Mbështetja dhe siguri i resurseve të shkollave për të bartur procesin e përmirësimit

Nominalisht shkollat në Maqedoninë e Veriut gëzojnë përkrahje të gjerë, në të cilën do të mund të mbështetet. Atyre iu sigurohet evaluim i rregullt jashtëm dhe realizojnë vetë-evaluimin e tyre të brendshëm. Po ashtu komunat gjenden afër shkollave dhe drejtpërsëdrejti i financojnë ato. Secila shkollë e posedon ekipin e vetë multi-profesional, i cili përfshin ekspertin pedagogjik ("pedagogun"), psikologun dhe këshilltarin për nevoja të posaçme mësimore (KNPM). Kjo shkallë e mbështetjes për shkollat individuale është e pazakonshme për shumicën e shteteve të OECD-së.

Sidoqoftë, shumica e shkollave veprojnë me kushte shumë të vështira. Historikisht bëhet ndarje jo e mjaftueshme e mjeteve financiare dhe ka mungesë të transparencës në ndarjen e mjeteve, andaj shumica e shkollave i kanë të mangëta resurset e nevojshme për t'i mbuluar shpenzimet themelore funksionale, me çka edhe nuk investojnë në përmirësimin e ambientit mësimdhënës. Roli i shkollave është i kufizuar në presionin lokal politik, i cili e kufizon aftësinë e tyre për udhëheqje efektive të përmirësimit të shkollës.



Shumë shkolla nuk kanë burime adekuate për të mbuluar shpenzimet e tyre themelore, dhe sigurisht jo të mjaftueshëm që të investojnë në përmirësime në mjedisin mësimor




Ngritja e rezultateve arsimore në Maqedoninë e Veriut do të varet në masë të madhe nga fuqizimi i kapaciteteve të shkollave për ta sajuar dhe drejtuar ambientin mësimdhënës. Ky shqyrtim ofron rekomandim për mënyrën sesi shkollat do të mund të mbështeten më mirë nga niveli qendror përmes kornizës dhe të dhënave për evaluim të shkollave, me qëllim që në mënyrë vendimtare të reflektohet në suksesin e tyre dhe të përcaktohen qëllimet e tyre për mësimdhënie dhe mësim. Po ashtu ky shqyrtim sugjeron mënyrën sesi shkollat do të mund të bëhen bashkësi mbështetëse për zhvillimin profesional të arsimtarëve, duke i fuqizuar praktikatat ekzistuese dhe premtuese, siç janë aktivitetet e arsimtarëve, vlerësimi i rregullt dhe ekipet për mbështetje multi-profesionale. Zhvillimi i arsimtarëve do të inkurajohet edhe nga njohja dhe iniciativat e ofruara nga rezultatet e reja të zhvillimit të karrierës së arsimtarëve të bazuara në suksesin e punës.

Tabela 0.2.

Shqyrtimi i OECD-së për evaluimin dhe notimin

Shqyrtimi i OECD-së vërteton sesi komponentët e evaluimit dhe notimit – notimi i nxënësve, vlerësimi i arsimtarëve dhe evaluimi i shkollave, vlerësimi i liderëve të shkollave dhe evaluimi i sistemit mund të zhvillohen në sinergji me të arriturat e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm (Grafiku 0.6).

Grafiku 0.6. Ndërveprimi mes kornizës së evaluimit dhe vlerësimit






Ky punim i ka përcaktuar tre shenja dalluese të evaluimit të fuqishëm dhe të kornizës së notimit:

▶ Përcaktimi i standardeve të qarta për atë që pritet nga nxënësit, arsimtarët dhe shkollat në nivel nacional dhe nga sistemi në përgjithësi. Shtetet të cilat arrijnë nivele të larta të cilësisë dhe barazisë përcaktojnë qëllime ambicioze për të gjithë, por gjithashtu ofrojnë përgjigje ndaj nevojave dhe konteksteve të ndryshme.

▶ Grumbullimi i të dhënave dhe informacioneve për suksesin aktual të mësimit dhe arsimit. Kjo është e rëndësishme për llogaridhënien, në mënyrë që të ndiqen qëllimet, por edhe për përmirësimin, ashtu që nxënësit, arsimtarët, shkollat dhe hartuesit e politikave të pranojnë informacion kthyes të nevojshëm për të reflektuar në mënyrë kritike lidhur me progresin e tyre dhe të ngelin të angazhuar dhe të motivuar për të arritur suksesin.


▶ Përbushja e koherencës në gjithë sistemin e evaluimit dhe notimit. Për shembull, kjo nënkupton që evaluimi i shkollës i vlerëson llojet e praktikave të mësimit dhe notimit, të cilat e mbështesin në mënyrë efektive mësimin e nxënësve, ndërsa arsimtarët vlerësohen në bazë të diturisë dhe shkathtësive për promovim të qëllimeve nacionale arsimore. Kjo është me rëndësi kritike për të siguruar që i tërë sistemi arsimor funksionon në drejtim të njëjtë, ndërsa resurset përdoren në mënyrë efektive.

Burimi: (OECD, 2013_[19]). *Sinergjitë për mësime më të mira: Perspektiva ndërkombëtare për evaluim dhe vlerësim*, OECD publikuar në Paris, <http://dx.doi.org/10.1787/9789264190658-en>





2. Përmirësimi i rezultateve të mësimit përmes vlerësimit të nxënësve



Në Maqedoninë e Veriut është vështirë të përdoret vlerësimi për ta mbështetur mësimin, për shkak se gjykimet e arsimtarëve për notim nuk bazohen në standardet nacionale për mësim, andaj edhe nuk ofrojnë informacione të besueshme për të ardhurat e nxënësve. Përkundër faktit që rezultatet e PISA-s zbulojnë që shumica e personave të moshës 15 vjeçare në shtet nuk mund të kryejnë detyra themelore kognitive, nga ana tjetër nxënësit e njëjtë marrin nota më të larta në klasë.

Gjithashtu notimi përmbledhës (sumativ) mbretëron si praktikë e notimit në klasë, madje është i kufizuar kah spektri i ngushtë i detyrave të rendit të ulët (sipas Taksonomisë së Blumit). Përkundër përpjekjeve të fundit të politikave për fuqizim të praktikave formuese të notimit, nxënësit pranojnë pak informacion kthyes cilësor, që iu ndihmon atyre ta avancojnë mësimin. Ata po ashtu kanë pak mundësi të demonstrojnë më shumë shkathtësi të zbatuar dhe kompetenca të ndërlikuara transversale, të cilat janë pjesë e programit mësimor të shtetit.



Nxënësit marrin pak informata kthyesore cilësore për t'i ndihmuar ata të kuptojnë se si të përparojnë në mësimin e tyre

Së fundi përderisa matura shtetërore është njëra ndër anët e fuqishme të sistemit të vlerësimit në Maqedoninë e Veriut, procedurat administrative janë të shëndosha, ndërsa rezultatet janë të besueshëm, megjithatë provimi duhet të evoluojë për ta ruajtur trendin me ndryshimet në sistemin arsimor. Në veçanti ky shqyrtim fokusohet në mënyrën sesi matura shtetërore do të mund të përshtatet për ta mbështetur qëllimin e qeverisë për përmirësim të cilësisë dhe atraktivitetit të drejttimeve të shkollave profesionale. Po ashtu ky hulumtim sugjeron që të rishikohet përmbajtja e maturës, me qëllim që të promovohet mësimi në një shkallë të gjerë të lëndëve në arsimin e përgjithshëm, për të vënë më mirë në pah dallimin nëpër niveleve të ndryshme të të arriturave të nxënësve dhe për avancim të besueshmërisë së rezultateve.

Çështja e politikës 21. Përmbajtja më kuptimplote të rezultateve të vlerësimit të nxënësve

Në Maqedoninë e Veriut, pritet jokonsistente të mësimin në raport me klasat dhe lëndët rezultojnë me nota jo të besueshme për nxënësit. Këto mospërputhje janë pasojë e mbështetjes së kufizuar për vlerësimin e njohurive të arsimtarëve dhe mungesës së koherencës së programit mësimor shtetëror, që i kombinon resurset e zhvilluara në kohëra të ndryshme përballë parimeve të ndryshme arsimore. Për shembull programi mësimor i matematikës për klasën IX, i bazuar në programin mësimor të Kembrixhit, fokusohet në kompetencat, siç janë parashtrimi i pyetjeve hulumtuese, duke përdorë metoda statistikore, ndërsa programi i matematikës në vitin e parë të shkollës së mesme (klasa X), i cili nuk bazohet në programin mësimor të Kembrixhit, ofron peshë shumë më të madhe për të

kryer detyra diskrete, siç është përlogaritja e numrit mesatar.

Njëkohësisht trajnimi i kufizuar i arsimtarëve në sajimin e notimit nënkupton që ata kanë prirje të rikthehen në teste të thjeshta të përsëritjes, për të cilat kanë më shumë njohuri, në vend se t'i vlerësojnë bashkëveprimet më të ndërlikuara të dijës dhe shkathtësive ose aftësive të rendit të lartë (sipas Taksonomisë së Blumit).

Sfidat në lidhje me vlerësimin e njohurive të arsimtarëve janë përkeqësuar nga shkalla e ngushtë e notimit në shtet nga nota 1 deri në notën 5, gjë që kombinohet me pritjet të larta të shoqërisë për nota të larta, andaj në klasë rezultojnë me nota të grumbulluara rreth notave katër dhe pesë. Për këtë arsye notat e fëmijëve përmbajnë shumë pak domethënie në lidhje me atë që mund ta bëjnë nxënësit, madje nuk iu ndihmojnë nxënësve në mënyrë efektive t'i kuptojnë anët e tyre të fuqishme dhe të dobëta.

Tabela 0.3.

Veprimet e rekomanduara për raportim të rezultateve të nxënësve

21.1. Zhvilloni standard koherente nacionale për mësim, të cilat përcaktojnë se çka duhet të dinë nxënësit dhe si pritet ata ta zbatojnë diturinë, për të promovuar vlerësime më të vlefshme dhe më të besueshme. Për ta rritur këtë të fundit, shtetet duhet t'i rishikojnë dhe përcaktojnë standardet mësimore

nëpër klasë të ndryshme, ashtu që do të skalitet mësimi i nxënësve dhe do të rritet ndërlikueshmëria e mësimin, gjegjësisht ngritet kah nivelet më të larta të Taksonomisë së Blumit. Prioritet të posaçëm duhet kushtuar standardeve në sferat bazë të mësimin, siç është matematika, mësimi dhe shkrimi, në veçanti për shkak se për shkrimin nuk ka standarde të notimit në klasat I-III.

Zhvillimi i standardeve të mësimin duhet të shoqërohet me prezantimin e niveleve të suksesit, të cilat i përcaktojnë

të arriturat e nxënësve përballë standardeve nacionale, p.sh. mbi përmbushjen ose ngeljen nën pritjet nacionale të mësimin. Kjo është në veçanti me rëndësi në klasat I-III, ku aktualisht nuk ka përshkrim të standardizuar të të arriturave të nxënësve.

21.2. Harmonizoni notimin e nxënësve me standardet nacionale të mësimin, duke iu ofruar mbështetje, siç është shpjegimi i qartë të kriterëve, të cilat i përkasin standardeve të ndryshme të mësimin dhe nivelet e tyre të suksesit; duke ofruar





rubrika për notim të nxënësve, shembuj të dukshëm të punës së nxënësve dhe vlerësim të notimit të tyre. Këto materiale do të mund të ofrohen përmes platformës në internet, ashtu që do të përfshijnë më shumë arsimtarë, do të mund më lehtë të azhurnohet dhe ta lehtësojë kontributin e arsimtarëve në përmbajtjen onlajn. Pasi të zhvillohet sistemi i ri (shihni Rekomandimet 5.2.1 dhe 5.2.2), arsimtarët duhet të inkurajohen t'i përdorin pyetjet e tij si inspirim për vlerësimin e tyre dhe ta krahasojnë punën e nxënësve të tyre me rezultatet e vlerësimit nacional për të

promovuar vlerësim më të saktë dhe më të besueshëm të klasës.

2.1.3. Rritja e saktësisë dhe vlerës arsimore të notimit dhe raportimit, duke e zgjeruar shkallën e notave të dhëna për vlerësim të klasës. Shkalla mund të shtrihet në 1-10, duke reflektuar praktika të ngjashme në rajon. Shkalla e re e notimit duhet të ndërlihet me standardet e reja të mësimit dhe suksesit (shih Rekomandimin 2.1.1). BZHA-ja mund t'iu ndihmojë arsimtarëve të përdorin shkallën e re të notimit, duke krijuar mundësi për ta lehtësuar dhe

drejtuar këtë proces, siç është ndihma e arsimtarëve për të notuar vlerësimet e ndërsjella dhe për të diskutuar në grupe për mënyrën e dhënies së notave.

Po ashtu shteti mund të shqyrtojë përfshirjen e një detyre projektuese në fund të arsimit lëndor (shkollë fillore), me qëllim që t'i informojë nxënësit lidhur me përzgjedhje e programeve të arsimit të mesëm, t'i motivojë të gjithë nxënësit që t'i zbatojnë vetë dhe të fuqizojnë standarde më të rrepta, në veçanti në lëndët kryesore.

Çështja e politikës 2.2. Fokusimi i praktikave të notimit për t'iu ndihmuar nxënësve në mësim

Në Maqedoninë e Veriut fokusi intensiv në notat përmbledhëse dhe perceptimin dominues i notimit si gjykim për suksesin e arritur i vë nën hije funksionet tjera të rëndësishme të notimit – duke ofruar informacione për përmirësim të mësimit. Kjo krijon një situatë në të cilën arsimtarët nuk arrijnë t'i shfrytëzojnë sa duhet rezultatet e notimit për t'iu ndihmuar nxënësve ta kuptojnë aftësinë e tyre të tanishme dhe për t'i përcaktuar hapat e ardhme të mësimit të tyre. Kjo bën që shumë nxënës të kalojnë nga një klasë në klasën tjetër pa mos i përmbushur pritjet për nivelin e tyre.

Dhënia dhe regjistrimi i informacioneve kthyes lehtë të kuptueshme është po ashtu aspekt kritik i notimit për mësim. Sidoqoftë në Maqedoninë e Veriut pothuajse një e treta e arsimtarëve të shkollave të mesme të analizuar për këtë raport kanë theksuar se “asnjëherë, pothuajse asnjëherë”,

ose vetëm herë pas herë kanë dhënë informacione kthyes me shkrim për nxënësit (përpos notës) (shih Kutinë 0.2). Njëkohësisht përderisa arsimtarët kanë kontakte të shpeshta me prindërit, vegla kryesore për të raportuar progresin e nxënësve – kartela (libreza) e nxënësve nuk ofron shumë informacione përshkruese në lidhje me mësimin e nxënësve, në veçanti pas klasës VI, kur nuk është e detyrueshme dhënia e informacioneve të këtilla.

Përderisa Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka bërë përpjekje të caktuara për t'iu inkurajuar arsimtarët ta përdorin notimin formues, vënia në praktikë të këtyre llojeve të notimit në klasës ngel sfidë. Përvoja e shteteve të OECD-së vërteton se kërkon mbështetje të fortë dhe të qëndrueshme për arsimtarët, siç nevojiten edhe resurset që kanë të bëjnë me notimin formues, zhvillimin profesional dhe iniciativat, të cilat e inkurajojnë përdorimin e tyre (OECD, 2013). Zhvillimi i këtij lloji të mbështetjes në Maqedoninë e Veriut do të duhet të plotësohet me adresimin e barrierave sistemore, të cilat ua vështirësojnë arsimtarëve përdorimin e rezultateve të notimit për ta përshtatur

mësimdhënien me nevojat dhe interesat e nxënësve. Një barrierë është programi mësimor i dendur dhe rigid. Rigjediteti i programit mësimor është përforcuar nga inspektimet e jashtme të shkollës

(“evaluimi integral”), që evaluon sesa për së afërmi shkollat i përmbahen programit mësimor, andaj i dekurajon shkollat për ta përshtatur programin mësimor në kontekstin e tyre specifik.

Tabela 04.

Rekomandimet për fokusim të mësimin të nxënësve

2.2.1. Promovimi i përdorimit të notimit diagnostik, në veçanti në klasat e hershme, me qëllim që t’iu ndihmohet arsimtarëve ta kuptojnë më mirë se deri në çfarë përmase nxënësit i përmbushin pritjet shtetërore dhe çfarë shkathtësi dhe dituri duhet të zhvillojnë më tej. Nga arsimtarët do të duhet të kërkohet të bëhet vlerësim diagnostik në fillim të klasave I-III dhe në bazë ad hoc si instrumente relevante i bazuar në Vlerësimin e hershëm të leximit në klasë të ulëta (EGRA) dhe në Vlerësimin e hershëm të matematikës në klasë të ulëta (EGMA), të cilat para do kohe janë përshtatur në kontekstin e Maqedonisë së Veriut. Ashtu siç arsimtarët bëhen më të rehatshëm në përdorimin e vlerësimit diagnostik, ata duhet të inkurajohen ta zhvillojnë vlerësimin e tyre personal, të bazuar në standardet nacionale të mësimin.

Po ashtu arsimtarët do të kenë nevojë për udhëzim në mënyrën e përdorimit të rezultateve nga vlerësimi diagnostik për identifikim të progresit të nxënësve dhe për të përpiluar mësimet e mëtejme.

2.2.2. Sigurimi dhe regjistrimi i informacionit kthyes të cilësisë së lartë për t’i ndihmuar nxënësit dhe prindërit t’i kuptojnë nevojat mësimore të nxënësve. Libreza e raportit të nxënësve duhet të azhurnohet për të ofruar më shumë hapësirë për informacion kthyes përshkrues, i cili shpjegon pse një nxënës e ka marrë ndonjë notë përkatëse. Kjo do t’iu ndihmojë nxënësve dhe prindërve t’i kuptojnë hapat e radhës për përmirësim të mësimin. Po ashtu shteti duhet të përkujdeset që ky informacion kthyes përshkrues të jetë sistematikisht i regjistruar dhe i ndarë, si për shembull në Sistemin e shtetit për menaxhim të informacioneve për arsim (EMIS), ashtu që prindërit, nxënësit dhe arsimtarët tjerë do të kenë qasje në informacionin kthyes të arsimtarëve tjerë. Ky dokumentim i vazhdueshëm do t’iu ndihmojë arsimtarëve t’i kuptojnë më mirë nevojat e nxënësve.

2.2.3. Mënjanimi i barrierave për të mundësuar notim formues, duke u përkujdesur që në mënyrë sistematike të gjitha shkollat të mund të ndajnë sasi të caktuar të kohës mësimore, ashtu siç dëshirojnë. Kjo do t’iu mundësojë arsimtarëve fleksibilitet më të madh, që ta shfrytëzojnë kohën e mësimdhënies për t’iu përgjigjur nevojave mësimore, të cilat i kanë vënë në pah rezultatet e notimit. Fleksibiliteti më i madh i programit mësimor duhet të përputhet me ndryshimet e kornizës për evaluim të shkollave, për t’u fokusuar në masat më të gjera siç është përmbushja e standardeve nacionale mësimore nga të arriturat e gjera të shkollave, e jo vetëm implementimi i detajuar i programit mësimor.

Për të përfituar nga autonomia më e madhe, arsimtarët do të duhet të kenë më shumë mbështetje për implementimin e votimit formues. BZHA-ja do të mund t’i mbështesë aktivitetet e arsimtarëve të shkollave për t’u fokusuar në çështjet e notimit praktik, siç janë teknikat e parashtrimit të pyetjeve për mënyrën e përdorimit të notimit të ri diagnostik.

Çështja e politikës 2.3. Azhurnimi i maturës shtetërore për inkurajim dhe vlerësim më të mirë të mësimin të nxënësve në sferat kryesore

Ekzistojnë një sërë mënyrash sesi matura shtetërore do të mund të revidohet për njohje më të mirë dhe

inkurajim të mësimin të nxënësve. Një çështje e tillë është përmasa e lëndëve të përfshira në provim. Për dallim nga provimet shtetërore në shumë shtete të OECD-së, në Maqedoninë e Veriut matematika nuk është provim i detyrueshëm (OECD, 2015). Si rezultat i kësaj në shumë pak shkolla të mesme nxënësit e marrin matematikën (përafërsisht 13%

në vitin 2017). Në nivel ndërkombëtar matematika së bashku me leximin dhe shkrimin konsiderohen si kompetenca bazë, të cilat nxënësit duhet t'i përvetësojnë në shkollë, gjegjësisht janë sferë, në të cilat informacionet për të arriturat e nxënësve janë të rëndësishme për të bërë përzgjedhje të informuar universitare. Çështje e ndërlidhur me këtë është fakti se edhe pse nxënësit në Maqedoninë e Veriut mësojnë shumë lëndë në shkollë – 15, që është numër më i madh sesa në shumicën e shteteve të OECD-së (Ofqual, 2012), megjithatë për *maturë* vlerësohen vetëm katër lëndë. Mospërputhja ndërmjet orarit të lëndëve dhe e provimeve të jashtme iu lë nxënësve pak hapësirë për njohje dhe pa mundësi për verifikim të dy të tretave të lëndëve, që ata i mësojnë.

Çështje tjetër është besueshmëria dhe krahasueshmëria e rezultateve të nxënësve. Një lëndë zgjedhore notohet në nivel të shkollës nga notues të shkollave të njëjta, të cilët e përpilojnë testin vetë. Edhe pse shkollat marrin instruksione në lidhje me përpilimin dhe notimin e testimit të nxënësve, dhe rezultoi me rreziqe se rezultatet nuk janë të besueshme dhe të krahasueshëm nëpër shkollat e ndryshme. Ekziston një brengosje e ngjashme në lidhje me temën e diplomës. Përderisa tema prezantohet me qëllim që të përfshijë komponentë autentike të notimit në kuadër të *maturës*, vlera e saj arsimore është e reduktuar për shkak se ka pak konsistencë në mënyrën sesi konceptualizohen projekte nëpër shkolla.

Çështja e tretë është se aktualisht *matura* nuk është shumë efektive në dallimin e niveleve të ndryshme të të arriturave të nxënësve. Kjo është pjesërisht për shkak se shkalla e notave 1-5 mundëson vetëm një gamë të kufizuar notave. Për shembull, në provimin e anglishtes për vitin 2017 një nxënës me 89 pikë e ka marrë notën e njëjtë (4) sikurse një nxënës me 65 pikë. Po ashtu reflekton shqetësimet me vetë testet, të cilat në disa lëndë nuk duket se përfshijnë pyetje të cilat bëjnë dallim të mjaftueshëm. Një numër i lëndëve kanë rezultat jashtëzakonisht të lartë të nxënësve, gjë që e parandalon identifikimin

e saktë të nxënësve me sukses më të mirë. Në maturë, një numër i vogël i nxënësve marrin lëndë të caktuara, siç është matematika dhe biologjia dhe ato kanë të ngjarë të jenë nxënës, të cilët e kanë paraparë se kanë gjasa të arrijnë rezultate shumë të mira. Për shembull rreth 60% të nxënësve kanë pasur së paku 75% të përgjigjeve të sakta në testin e biologjisë, mirëpo vetëm 7.6% kanë pasur sukses në testin e gjuhës angleze. Aktualisht QSHP-ja nuk prodhon në mënyrë sistematike llojin e analizës së pyetjeve të testit, që do t'iu ndihmonte hartuesve të pyetjeve të kuptojnë nëse vështirësia e tyre është e përshtatshme për audiencën e targetuar për provim.

Çështja përfundimtare është përputhja e *maturës* me qëllimin e Maqedonisë së Veriut për ta përmirësuar qëllimin e arsimit profesional. Aktualisht nxënësit e regjistruar në programet katërvjeçare të shkollave profesionale (rreth 50% të grupit të nxënësve të shkollave të mesme) i përmbushin kushtet për ta bërë maturën, me çka iu jepet atyre mundësia për ta vazhduar arsimin sipëror ose për t'u futur drejtpërsëdrejti në tregun e punës. Sidoqoftë struktura e tanishme e maturës, ku lëndët profesionale vlerësohen në nivel të shkollës, nënkupton se nxënësit e shkollave të mesme profesionale katërvjeçare nuk diplomohen me asnjë certifikim për vlefshmëri të jashtme në sferën e tyre profesionale. Kjo nënkupton se nxënësit nuk zhvillojnë njohje kuptimplote të shkathtësive të tyre profesionale, gjegjësisht rezultatet e lëndëve profesionale nuk fitohen nga autoriteti i njëjtë i jashtëm, siç është rasti me lëndët e drejtimit të përgjithshme. Tani si pjesë e reformës më të gjerë për përmirësim të cilësisë dhe prestigjit të shkollave të mesme profesionale shteti është duke e konsideruar zhvillimin e maturës së posaçme për shkollat të mesme profesionale. Megjithatë ky rishikim sugjeron që qëllimet nacionale për shkollat e mesme profesionale do të mund të arrihet më së miri, duke e bërë më fleksibil modelin e maturës ekzistuese dhe duke i lejuar atij t'i verifikojë arritjet në fushën e arsimit profesional.

Tabela 0.5.

Rekomandimet
për revidimin
e maturës
shtetërore

2.3.1. Revidimi i strukturës së maturës për të siguruar rezultate më kuptimplota në temat kyçe, duke:

- ▶ Bërë lëndën e matematikës të detyrueshme për t'i motivuar të gjithë nxënësit ta përvetësojnë së paku matematikën themelore, por edhe për t'iu ndihmuar universiteteve të marrin vendime më të adekuata në lidhje me përzgjedhjen e nxënësve në drejtimin e matematikës dhe në drejtimeve tjera të përafërta.
- ▶ Krijuar dy versione të provimeve të matematikës, në nivelin themelor dhe atë më të avancuar, me qëllim që të sigurohet certifikim në matematikë, i cili është i dobishëm dhe i qasshëm për të gjithë nxënësit, ndërsa nxënësve të cilët e vijojnë studimin e matematikës në nivelin sipëror, t'iu jepet mundësia të studiojnë koncepte më të avancuara.
- ▶ Konsideruar zgjerimin e mëtejme të lëndëve themelore, të cilat vlerësohen se përputhen më mirë me numrin e lartë të lëndëve të studiuara dhe të atyre të vlerësuara.
- ▶ Bërë notim të jashtëm (ekstern) të gjitha lëndëve, që të rritet vlera e lëndëve, të cilat paraprakisht janë notuar nga vetë shkolla dhe të përmirësohet besueshmëria e përgjithshme e rezultateve të maturës.
- ▶ Standardizuar temat e diplomës, përmes kufizimit të temave dhe

formatit dhe duke ofruara shembuj të temave të pranuar të diplomës dhe udhëzime për personelin e shkollës për mënyrën sesi të mbikëqyren dhe vlerësohen ato. Drejtimi i rregullt i jashtëm nga QSHP-ja dhe BZHA-ja mund po ashtu të zbatohet, me qëllim që të sigurohet ruajtja e cilësisë.

2.3.2. Përshtatni notimin dhe përmirësoni cilësinë e pyetjeve të testeve për të siguruar dallim më të madh të aftësive të nxënësve dhe për t'i motivuar ata ta përmirësojnë mësimin e tyre. QSHP-ja duhet t'i analizojë pyetjet e testeve pas çdo administrimi të *maturës* shtetërore, që të mësojë sesi nxënësit ia kanë dalë me to. Analiza mund të kontribuojë në zhvillimin e mëtejme të pyetjeve, në mënyrë që të mos ketë shumë pyetje tepër të lehta, tepër të vështira, ose pyetje me potencial të ulët për të bërë diferencimin mes dijeve dhe shkathtësive të nxënësve. Realizimi i këtyre procedurave do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë dhe normalizimin e shkallëzimit të notave të nxënësve. Po ashtu shteti duhet të shqyrtojë zgjerimin e skemës së notimit në përputhje me ndryshimet e skemës së notimit në klasë me nota 1-10 (Rekomandimi 2.3.2), që të mundësojë sigurim të fushëveprimit më të madh të diferencimit ndërmjet niveleve të ndryshme të suksesit.


2.3.3. Fuqizoni komponentin e arsimit profesional duke iu dhënë vlefshmëri të jashtme nxënësve në lëndët e arsimit profesional dhe duke i ndërlidhur ato me

rezultatet e certifikimit të njohura nga punëdhënësi. Lëndët e arsimit profesional të verifikuara nga jashtë duhet t'iu ofrojnë nxënësve dëftesa formale për arsim profesional, të integruara në kornizën nacionale për kualifikim të Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të sinjalizohet gatishmëria e punëdhënësve dhe fakulteteve teknike të arsimit sipëror. Nxënësit e arsimit profesional duhet t'i kompletojnë temat e tyre të *maturës* në lëndën e përzgjedhur të arsimit profesional, me qëllim që të ofrojnë njohje më të madhe dhe kohë për zhvillimin e shkathtësive profesionale.

Për ta bërë certifikimin profesional më të arritshëm, 150+ specializimet e ndryshme duhet ta reduktohen në një numër të vogël të lëndëve, që kanë të bëjnë me sektorët, të cilët janë identifikuar si të rëndësishëm nga vlerësimet e ekonomisë dhe punës. Me kalimin e kohës specializimit ekzistuese të arsimit profesional do të mund të konsolidohen në gamën e drejtimeve profesionale, ashtu që nxënësit nuk do t'i ndjekin drejtimet, të cilat janë shumë të ngushta, me çka do ta kufizojnë punësimin e tyre në të ardhmen. Meqenëse Qendra për Arsim Profesional nuk posedon kapacitete për t'i përpiluar dhe notuar të gjitha testet, mund të nevojitet të përfshihet një organi punëdhënësish ose asociacionesh profesionale për përgatitje dhe notim.



3. Përdorimi i vlerësimit të arsimtarëve në mbështetjen dhe inicimin e mësimdhënies së mirë



Cilësia e lartë e mësimdhënies është vërtetuar se është faktori më i rëndësishëm i nivelit të shkollës në raport me rezultatet e mësimin të nxënësve. Sistemet efektive arsimore kanë vënë theks të veçantë në përzgjedhjen, trajnimin dhe mbajtjen e arsimtarëve me kompetencat e nevojshme, për t'iu ndihmuar nxënësve të arrijnë sukses. (Schleicher, Teaching Excellence through Professional Learning and Policy Reform: Lessons from Around the World, 2016). Vlerësimi e mbështet kulturën e profesionalizmit, duke siguruar fillimisht që të gjithë arsimtarët të kenë aftësi për mësimdhënie, po ashtu duke u përpjekur për nxitje të arsimtarëve të zhvillojnë nivele më të larta të ekspertizës dhe përgjegjësisë përgjatë karrierës së tyre.

Gjatë viteve të fundit Maqedonia e Veriut ka bërë një sërë përpjekjesh për të krijuar një metodë më të fuqishme për përzgjedhje dhe promovim të metodave, me qëllim që të themelohet një sistem më shumë i përqëndruar te nxënësi. Iniciativat përfshijnë propozim për strukturën e karrierës së bazuar në meritë për arsimtarët si dhe përpjekje për mbështetje të zhvillimit profesional të arsimtarëve në sferat kyçe, siç janë teknikat për notim në klasë. Sidoqoftë përpjekjet nuk kanë qenë të qëndrueshme pasi që sistemi i karrierës i bazuar në meritë ende nuk është implementuar dhe nuk është në përmasën e politikës së përgjithshme për mbështetje të profesioneve mësimore.

Çështja e politikës 3.1.

Sigurimi që përfshirja dhe progresi në rrugëtimin e karrierës së arsimtarit të bazohet në kompetencat profesionale

Në vitin 2016 BZHA në bashkëpunim me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) e zhvilloi një plan për t'ua prezantuar arsimtarëve rrugëtimin e karrierës së bazuar në sukses. Struktura e re e karrierës ka përcaktuar hapa të ndryshme në lidhje me ndërlidhjen e niveleve të kompetencave të mësimdhënies dhe sistemin e ri të vlerësimit, me qëllim që të përcaktohet mënyra sesi do të avancoheshin arsimtarët. Zhvillimi i mëtejshëm i planeve për ta prezantuar rrugëtimin e karrierës së bazuar në suksesin e punës në Maqedoninë e Veriut do t'i inkurajojë arsimtarët të zhvillojnë shkathtësi të reja dhe të marrin role dhe përgjegjësi të reja.

Njëkohësisht përderisa rritet menaxhimi i talentit në kuadër të veprimtarisë ekzistuese të arsimtarëve, Maqedonia e Veriut duhet të përkujdeset që të ketë përzgjedhje më të rreptë dhe përgatitje të arsimtarëve të rinj në profesion, që edhe ata të bëhen arsimtarë të përgatitur në të ardhmen. Sistemet arsimore me shumë sukses investojnë në masë të madhe në tërheqjen dhe përzgjedhjen e kandidatëve talentë dhe të motivuar për mësimdhënie, por edhe përkujdesen t'iu ofrojë atyre trajnim adekuat për zhvillim të kompetencave të nevojshme për t'u bërë arsimtarë efektivë (Schleicher, Schools for 21st-Century Learners: Strong Leaders, Confident Teachers, Innovative Approaches, 2015). Sidoqoftë në Maqedoninë e Veriut nuk ka përzgjedhje në regjistrimin e kandidatëve për studentë në drejtimet pedagogjike, ku pothuajse

pranohen të gjithë aplikuesit në këto programe studimore (Mickovska, Vera Kondik Mitkovska Loreta Georgieva, Aleksandar Stamboliev, Besa Reci, Ceslarov, & Visinska Buzarovska, 2013). Kjo jo vetëm që nënkupton se studentët e ri nuk i posedojnë parakushtet kryesore, si dija themelore akademike dhe motivi, por ndikon edhe në statusin e profesionit të arsimtarit dhe atraktivitetin e tij për nxënësit me sukses më shembullor. Kjo gjendje po ashtu shkakton mbingarkim me numër të madh të arsimtarëve të rinj, që paraqet përdorim joefikas të resurseve qeveritare (pasi që të gjitha studimet në drejtimin pedagogjik janë të subvencionuara me kuotë shtetërore).



Ka pak zgjedhje në fakultetet e mësimdhënësve, dhe pothuajse të gjithë ata që aplikojnë regjistrohen

Situata e mësipërme është e përkeqësuar nga mungesa e mekanizmave të fuqishme për të siguruar gatishmërinë e të diplomuarve në drejtimet pedagogjike. Maqedonia e Veriut ka mungesë të kriterëve specifike për akreditim të programeve pedagogjike për arsimtarë dhe kërkesat e fuqishme për licencim inicial të arsimtarëve dhe udhëzim adekuat për vlerësim të periudhës provë dhe mentorim. Në përgjithësi përzgjedhja e dobët e sigurimit të mekanizmave të cilësisë së përfshirjes

në procesin e mësimdhënies e përkeqëson rrezikun, që arsimtarët e rinj të futen në këtë profesion pa nivel minimal të dijes dhe shkathtësive për të qenë efektivë në klasë. Ministria e Arsimit dhe Shkencës e vetëdijshme për këto sfida, kohëve të fundit ka propozuar të krijohet një akademi, e cila do ta plotësojë edhe një vit shtesë të arsimit pedagogjik në përfundim të diplomimit të kandidatit, me qëllim të përzgjedhjes dhe trajnimit të kandidatëve për arsimtarë. Përderisa qëllimi i akademisë është pozitiv, ai nuk i adreson problemet më të thella të mungesës së përzgjedhjes dhe heterogjenisë në cilësinë e programeve pedagogjike. Në vend se të shtohet një vit i ri (shtresë e re) të përgatitjes initiale do të ishte më efektive dhe efikase nëse arsimit pedagogjik do të bëhej më selektiv dhe më rigoroz.




Tabela 0.6.

Rekomandimet për regjistrimin, progresin dhe rrugëtimin drejt ndërtimit të karrierës

3.1.1. Përfshirja e strukturës së planifikuar për karrierë të arsimtarëve të bazuar në sukses.

Çështjet lidhur me mënyrën sesi do të vlerësohen arsimtarët që kërkojnë avancim dhe ndikimi në rrogat e arsimtarëve nuk janë trajtuar në planet e vitit 2016, andaj hapi i parë i MASH-it dhe BZHA-së do të jetë të qartësohet procesi i vlerësimit të jashtëm (esktern). Kjo do të përfshijë zhvillimin e udhëzimeve për vlerësuesit në lidhje me llojin e dëshmive, të cilat ata duhet t'i grumbullojnë për ta vlerësuar gatishmërinë e arsimtarëve për avancim (p.sh. observime në klasë, rishikim të portofolit të arsimtarëve dhe intervista me kandidatët). Indikatorët dhe përshkruesit e cilësisë së mësimdhënies duhet gjithashtu të zhvillohen, me qëllim që të orientohen vlerësuesit drejt asaj në çka duhet të fokusohen dhe kur t'i observojnë praktikën e mësimdhënies. E tërë kjo duhet të shoqërohet me trajnim të vlerësuesve, në mënyrë që të vlerësohen kompetencat e arsimtarëve në përputhje me standardet e mësimdhënies.

Ministria duhet gjithashtu ta përcaktojë mënyrën sesi vlerësimi i ri do të ndikojë në aspekte tjera të politikave për arsimtarë, duke përfshirë edhe ngritjen në karrierë me rritjen e rrogave, me qëllim që të valorizohet sukcesi. Arsimtarët do të duhet të mbështeten për ta identifikuar dhe ushtruar zhvillimin profesional, i cili do t'i ndihmojë atyre në avancimin e rrugës së re të karrierës. Një mënyrë për ta mbështetur këtë është përmes identifikimit të qartë të kompetencave të mësimdhënies të potencuara nga programet e akredituara për trajnim në katalogun e ri për zhvillim profesional (Rekomandimi 3.3.1). Një aspekt tjetër është organizimi i trajnimit për drejtorët e shkollave dhe pedagogët në lidhje mënyrën e orientimit të arsimtarëve drejt zhvillimit profesional, i cili më së miri i përmbush nevojat e tyre.

3.1.2. Përzgjedhja e kandidatëve më të kualifikuar për mësimdhënie dhe përkujdesi që ata të marrin mbështetje adekuate gjatë periudhës së angazhuar në provë. Përzgjedhja më e madhe e aspirantëve për arsimtarëve në programet për trajnim të arsimtarëve do të mund të arrihet duke i zvogëluar kuotat e drejtimeve

të fakulteteve pedagogjike të financuara nga qeveria dhe kërkimi që kandidatët t'i marrin së paku notat minimale të maturës në lëndët bazë, siç është gjuha amtare dhe matematika. Në të ardhmen, universitetet do të mund gjithashtu të inkurajohen ta vlerësojnë motivin e kandidatëve dhe shkathtësitë e tyre socio-emocionale. Për shembull do të mund ta bëjnë atë përmes intervistave. Ministria duhet të përfshijë kritere të akredituara specifike për programet në përputhje me standardet mësimore të vitit 2016 që të ndihmojë të sigurohet që të gjitha programet pedagogjike (inicialet për trajnim të arsimtarëve) të ofrojnë trajnim cilësor teorik dhe praktik.

Ministria duhet gjithashtu ta shqyrtojë mundësinë për mekanizma më të fuqishme për licencim fillestar dhe të plotë të arsimtarëve. Një opsion është të vihet në zbatim një provim shtetëror për kualifikim në fund të arsimit inicial për arsimtarë, në mënyrë që të gjithë arsimtarët e përzgjedhur t'i përmbushin të gjithë kushtet e përcaktuara minimale. Ky provim i ri do të mund ta zëvendësojë provimin e diplomës në fund të periudhës së angazhuar në



provë, me qëllim që të shmanget dyfishimi i provimeve. Po ashtu, provimi nevojitet të shoqërohet nga një vlerësim më të fuqishëm të periudhës së angazhuar në provë, në mënyrë që të vlerësohen praktikat e klasës dhe atributet tjera, të cilat është vështirë të vlerësohen në provim. Vlerësuesit e BZHA-së mund të bëhen vendimmarrësit e fundit për vlerësim të periudhës

së angazhuar në provë, duke pasur parasysh rolin e madh që ka ky vendim për karrierën e arsimtarit. Të gjithë arsimtarëve të rinj duhet gjithashtu t'iu përcaktohet nga një mentor, i cili do të mund të raportoje në lidhje me punën e tyre përgjatë vitit, edhe si kontribut për vlerësimin e periudhës së angazhuar në provë, por edhe për të ofruar më shumë informacion kthyes

formues. Me rëndësi është që të kushtohet vëmendje që të gjithë arsimtarët e rinj të përvetësojnë mentorim cilësor gjatë periudhës së angazhuar në provë, sepse në atë mënyrë ata do të mbështeten në zhvillimin e diturive dhe shkathtësive të tyre pedagogjike, duke e pasur parasysh fakti që shumica prej tyre nuk kanë përfutur nga praktika cilësore.

Çështja e politikës 3.2. Zhvillimi i kulturës së mësimi dhe informacioneve kthyes në shkollë

Mbështetja e arsimtarëve në nivel të shkollave, e cila është e qëndrueshme dhe e ndërlidhur me praktikat e tyre ditore është ndër tipat më efektive të zhvillimit profesional dhe mësimi. Në Maqedoninë e Veriut ekzistojnë një sërë praktikash shkollore për t'iu ndihmuar arsimtarëve. Kjo përfshin kulturën joformale të bashkëpunimit ndërmjet arsimtarëve përmes shkëmbimit të materialeve, diskutimit të mësimi të nxënësve dhe punës mes vete si pjesë e "aktivatë të arsimtarëve", gjegjësisht grupeve të arsimtarëve të lëndëve përkatëse brenda shkollës. Po ashtu secila shkollë ka ekipe shumë-profesionale për mbështetje, të cilat përbëhen nga pedagogët, këshilltari për nevoja të posaçme arsimore, psikologu dhe drejtori, që pritet t'iu ndihmojnë arsimtarëve t'iu përgjigjen nevojave të ndryshme mësimore të nxënësve. Drejtorët dhe pedagogët e drejtojnë vlerësimin e arsimtarëve brenda shkollës.

Ndonëse këto praktika janë pozitive, ato mund të ofrojnë mbështetje me të fuqishme për arsimtarët. Për shembull, është e paqartë nëse "aktivat e arsimtarëve" janë efektive në shkollë, ose kanë ndonjë mungesë të mbështetjes së jashtme ose të mjeteve financiare. Vlerësimi i rregullt duhet gjithashtu të jetë i fokusuar në mënyrë më efektive

në aspektet më të rëndësishme të mësimdhënies për mësim dhe i ndërlidhur me standardet e zakonshme të mësimdhënies. Aktualisht vlerësuesit në nivel të shkollës, pra drejtorët dhe pedagogët, nuk ndjekin trajnim të domosdoshëm dhe mbështetje teknike për ta bërë vlerësimin një ushtrimi kuptimplotë (Mickovska, Vera Kondik Mitkovska Loreta Georgieva, Aleksandar Stamboliev, Besa Reci, Ceslarov, & Visinska Buzarovska, 2013). Çështje tjetër është dyfishimi aktual i proceseve të vlerësimi, pasi që vlerësimi bëhet nga inspektorët e ISHA-s si pjesë e evaluimit të jashtëm të shkollave nga këshilltarët e BZHA-së, si dhe vlerësimi në nivel të shkollës që bëhet nga drejtorja e shkollës. Këto procese nuk janë të koordinuara, në masë të madhe kanë karakter administrativ dhe shfaqin pak dëshmi për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies.

Për fund ekipet e mbështetjes multiprofesionale duket se operojnë sipas definicionit shumë të ngushtë të mbështetjes mësimore. Në një sërë shkollash të vizituara nga ekipi shqyrtues pedagogët e perceptojnë rolin e tyre si të limituar në drejtim të ndihmesës së arsimtarëve për t'i menaxhuar "problemet" e nxënësve me rrezik të madh të dështimit, në vend se t'i ndihmojnë arsimtarët t'i kuptojnë nevojat mësimore të secilit nxënës dhe t'iu ndihmojnë atyre të hartojnë plane mësimore, të cilat krijojnë mjedis mësimor më inkluziv dhe më efektiv.

Tabela 0.7.

Rekomandimet për zhvillim të mësimin dhe informacionit kthyes nëpër shkolla

3.2.1. Udhëzoni drejtorët dhe pedagogët ta bëjnë proces kuptimplotë vlerësimin e rregullt të arsimtarëve.

Duke pasur parasysh përmasën e madhe dhe dyfishimin e krijuar nga tre procese të rregullta të vlerësimit, ky shqyrtim rekomandon përjashtimin e rolit të BZHA-së dhe ISHA-s nga procesi i vlerësimit të rregullt. Në këtë mënyrë drejtorët dhe pedagogët do të mund të menaxhojnë vlerësimin në nivel të shkollës. Kjo është në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe hulumtimin, i cili e potencon vlerën e drejtimit të vlerësimeve nga vetë shkollat, pasi që ata kanë kuptim më të saktë të suksesit të arsimtarëve dhe mund të zhvillojnë bisedë shumë më të hapur, e cila i përçon qëllimet zhvillimore të vlerësimit të rregullt të arsimtarëve (OECD, 2013).

Drejtorët dhe pedagogët do të kenë nevojë për mbështetje të fokusit të vlerësimit të rregullt për evaluim të arsimtarëve në raport me standardet e reja mësimore të mësimdhënies (pasi që ato të vihen në praktikë)

dhe ta inkurajojnë zhvillimin drejt niveleve më të larta të kompetencave të mësimdhënies përmes:

- ▶ Udhëzimet për mënyrat e observimit të dëshmive të kompetencave të reja të arsimtarëve.
- ▶ Sugjerimi për mënyrën e përdorimit të portofolave të arsimtarëve në mënyrë më kuptimplotë, si për shembull fokusimi i qëllimeve mësimore të arsimtarëve në planin e tyre zhvillimor.
- ▶ Përfshirja e vetë-vvaluimit të arsimtarëve për inkurajim të arsimtarëve, me qëllim që të reflektohet në praktikën e tyre të mësimdhënies dhe qëllimet e zhvillimit.
- ▶ Krijimi i planit zhvillimor, i cili i identifikon fushat specifike, diskrete të mësimin dhe përmirësimi për vitin e ardhshëm.

Drejtorët e shkollave dhe pedagogët, të cilët bëjnë vlerësim të rregullt, duhet gjithashtu të ndjekin trajnim për teknikat e vlerësimit. Në përgatitjen bazë për drejtorë duhet të përfshihet edhe udhëzim praktik për mënyrën e observimit të mësimdhënies dhe ofrimit të informacionit kthyes formues. Për këtë arsye duhet të zhvillohen sesione të trajnimit për drejtorët dhe pedagogët në detyrë.

3.2.2. Zhvillimi i grupeve

“aktivave” të arsimtarëve, duke iu ofruar atyre rol në zhvillimin profesional të arsimtarëve. Për shembull BZHA-ja mund të ofrojë shembuj të aktiviteteve të bashkëpunimit për zhvillim profesional, të cilat do të mund t'i realizojnë “aktivat e arsimtarëve” siç janë për shembull observimet e mësimdhënies nëpër klasa dhe organizimi i trajnimit në suaza të shkollës. BZHA-ja duhet gjithashtu të përcaktojë një koordinator për trajnim të “aktivave të arsimtarëve”, me qëllim që të sigurojë se ato zhvillohen paralelisht me shkollën. “Aktivat” do të mund të furnizohen me një numër të vogël të fondeve të lira për realizim të aktiviteteve të tyre zhvillimore.

3.2.3. Rishikimi i rolit të ekipit për mbështetje brenda shkollës,

me qëllim të fokusimit në ndihmesën e arsimtarëve për të krijuar mjedis efektiv dhe inkluziv për mësim. Një mundësi është të përfshihet një model mbështetës shumë-shtresor, i cili fron “shtresa” të ndryshme të përkrahjes për t'i përmbushur nevojat e ndryshme të atyre që mësojnë, ngjashëm me qasjen e përdorë në Finlandë (Mitchell, 2014^[30]). Ekipi mbështetës mund të takohet rregullisht si grup për rishikim të planeve mësimore të arsimtarëve në mënyrë





që arsimtarët t'i identifikojnë nevojat e ndryshme mësimore të nxënësve në klasat e tyre (p.sh. kush është në rrugën e duhur për përmbushje të standardeve shtetërore, kush ka nevojë për ndihmë të mëtejme dhe kush duhet të sfidohet), si dhe t'i vënë në praktikë strategjitë e diferencuara për përmbushje të këtyre nevojave. Përpos ndihmës së arsimtarëve për t'i adresuar rastet specifike të atyre që kanë vështirësi, ekipi në fjalë po ashtu do t'iu ofrojnë

arsimtarëve këshillë për qasjen e gjerë në klasë, me qëllim që të përmirësohen rezultatet e mësimi, siç është fillimi i vitit shkollor ndihma e arsimtarëve në zhvillimin e planeve efektive për vitin e ardhshëm në fund të strategjive të diskutuara, që janë më shumë ose më pak efektive. Këta role të reja duhet të reflektohen në standardet e kompetencës për personelin mbështetës të shkollës, si pjesë e implementimit të strukturës së karrierës së bazuar në

sukses (Rekomandimi 3.1.1). Po ashtu MASH-i do të duhet të përkujdeset që trajnimi fillestar i personelit mbështetës të shkollës të përputhet me këto standarde dhe koncepte moderne të nevojave të posaçme arsimore dhe arsimit inkluziv, si dhe të përcaktohen kërkesat e detyrueshme për trajnim të pedagogëve ekzistues dhe këshilltarëve për nevoja të posaçme arsimore për t'iu ndihmuar atyre t'i kuptojnë dhe zbatojnë metodat e reja.

Çështja e politikës 3.3. Fuqizimi i mbështetjes së jashtme për zhvillim profesional të arsimtarëve

Ndonëse është i rëndësishëm zhvillimi profesional për mbështetje të arsimtarëve në përvetësimin e praktikave më efektive, trajnimit të jashtë i ngel një rol i rëndësishëm, në veçanti në kontekstin, në të cilin gjendet Maqedonia e Veriut, ku hendeku mes njohurive dhe shkathtësive të arsimtarëve është i madh, ndërsa kapaciteti i vërtetë i liderimit pedagogjik në shumicën e shkollave ngel i dobët. Sidoqoftë tani ka shqetësime në kuadër të qasjes dhe cilësisë së kurseve të jashtme për trajnim në shtet. Niveli i përvetësimit të zhvillimit profesional është relativisht i ulët në krahasim me shtetet e OECD-së dhe ato të Ballkanit Perëndimor, madje shkollave i ndahet shumë pak mbështetje financiare për ta organizuar trajnimin në vendin e punës për personelin e tyre. Meqenëse është e kufizuar qasja në programet zyrtare për trajnim, shpeshherë arsimtarët në Maqedoninë e Veriut vetë i gjejnë dhe i paguajnë trajnimet, ose fokusohen në mbështetjen

joformale, siç është interneti, me qëllim që të kenë qasje në materialet për mësimdhënie. Interneti ua lehtëson arsimtarëve bashkëpunimin mes vete edhe përtej shkollave të tyre dhe e rrit gamën e mjeteve mësimore, të cilave arsimtarët mund t'iu referohen (Schleicher, Teaching Excellence through Professional Learning and Policy Reform: Lessons from Around the World, 2016). Megjithatë MASH-i duhet të ndërmerret një rol më aktiv në rishikimin e përmbajtjeve dhe platformave të internetit, nëse synohet që ky resurs të përdoret në mënyrë efektive për t'i përmirësuar praktikatat e mësimdhënies. Zhvillimi profesional i arsimtarëve i bazuar në nevojat tregut në shtet duhet po ashtu të plotësohet me mekanizma më të fuqishme për sigurim të cilësisë.




Tabela 0.8.

Rekomandime
për mbështetje
të zhvillimit
profesional të
arsimtarëve

3.3.1. Të sigurohet që zhvillimi profesional t'i përmbush nevojat e arsimtarëve. Në të kaluarën BZHA-ja ka qenë përgjegjëse për mirëmbajtje të katalogut të programit të akredituar për zhvillim profesional të arsimtarëve. Ky rol duhet të rivendoset, në mënyrë që arsimtarët ta përvetësojnë zhvillim profesional, i cili i përmbush kriteret minimale të cilësisë. Procesi i akreditimit duhet të kontrollojë, nëse programet iu referohen kompetencave themelore të arsimtarëve, siç janë definuar në standardet e reja të mësimdhënies dhe janë harmonizuara me prioritetet nacionale për mësimdhënie dhe mësim, të përcaktuara në Strategjinë për arsim 2018-2025.

Po ashtu MASH-i duhet t'i rishikojë edhe përmasën edhe mënyrën e financimit të zhvillimit profesional. BZHA-ja kërkon numër shumë më të madh të resurseve, nëse duhet të ofrojë

10 orë trajnim falas në sferat me prioritet shtetëror, të cilat të gjithë arsimtarët e kanë për detyrë ti ndjekin në çdo tre vite. Përveç kësaj bllok donacionet duhet t'iu jepen drejtpërsëdrejti shkollave si fonde diskrecionale, që t'i përdorin për ta zgjedh trajnimin në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre.


3.3.2. Zhvillimi i më shumë resurseve digjitale për mbështetje të zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Pasi që dy të tretat e arsimtarëve të shkollave veç më mbështeten fuqishëm në mjetet për notim të nxënësve dhe në planet mësimore nga interneti (OECD & UNICEF, OECD-UNICEF survey of teachers and principals in North Macedonia, 2018), BZHA-ja do të mund të krijojë një bazë nacionale në internet për ta avancuar më tej këtë praktikë. BZHA-ja do të mund t'i plotësojë materialet e ofruara nga arsimtarët, në të cilat ka boshllëqe, si dhe mund të përkujdeset që materialet e tilla t'i përmbushin kriteret minimale të cilësisë. Po ashtu këto materiale mund të shqyrtohen nga kolegët e profilit dhe rangut të njëjtë. Për ta inkurajuar bashkëpunimin arsimtarëve,

baza e tillë e të dhënave do të mund të përfshijë një forum në rrjetin e internetit, në të cilin arsimtarët do të mund të bashkëpunojnë dhe t'i zgjidhin problemet, me të cilat përballen në praktikën e tyre të mësimdhënies.

3.3.3. Fuqizimi i rolit të BZHA-së. Një shqetësim më i gjerë për mësimdhënien në Maqedoninë e Veriut është mungesa e qasjes gjithëpërfshirëse për zhvillim të profesionit. Programet dhe politikat e fundit kanë qenë të mbështetura në mënyrë të qëndrueshme, i njëjtë është rasti edhe me zhvillimin e standardeve të mësimdhënies dhe qasjen për zhvillim të karrierës së bazuar në sukses, të cilat kanë ngel të paimplementuara. Fuqizimi i BZHA-së, me qëllim që të njihet formalisht si organ kyç qeveritar për mbështetje të profesionit të mësimdhënies, do të ndihmojë që të sigurohet që mësimdhënia të konsiderohet si prioritet politik. BZHA-ja e reformuar do të jetë përgjegjëse për fushat kyçe të politikave në lidhje me arsimtarët, duke hartuar rekomandime për zhvillim të politikave dhe duke e këshilluar ministrin.



4. Ndërlidhja e evaluimit të shkollave me qëllimet e saja themelore të llogaridhënies dhe përmirësimit



Qëllimi i evaluimit të shkollave është që t'iu ndihmojë atyre t'i përmirësojnë praktikat shkollore dhe t'i mbajnë ato përgjegjëse për cilësinë e arsimit, që ua ofrojnë nxënësve. Maqedonia e Veriut e posedon një kornizë për evaluim të shkollave, e cila i përfshin sferat kryesore të rëndësishme për sistemin efektiv të evaluimit të tyre. Sidoqoftë, kjo kornizë nuk është implementuar plotësisht ose nuk është përvetësuar nga palët përkatëse. Edhe vlerësimi i jashtëm (ekstern) edhe vetëevalumi në masë të madhe fokusohen në përputhjen me kornizën, sesa me inkurajimin e kulturës së reflektimit dhe përmirësimit të shkollave. Në parim kjo gjendje reflekton një shkëputje ndërmjet qëllimeve të kornizës, që është avancimi i cilësisë së shkollave dhe përmirësimi i drejtuar nga vetë shkollat, si dhe perceptimin e evaluimit ndërmjet inspektorëve dhe shkollave si kërkesa administrative. Kjo gjendje është përkeqësuar nga një kornizë e dobishme, por edhe e ndërlikuar, të cilën e kanë vështirë ta zbatojnë inspektorët dhe shkollat, si dhe nga mungesa e mbështetjes së shkollave për mënyrën e përdorimit të rezultateve të evaluimit për t'i formësuar përpjekjet për përmirësim.



Vlerësimi i shkollës inkurajon më shumë përputhshmërinë procedurale, se sa përmirësimet në rezultatet e mësimdhënies dhe mësimin

Çështja e politikës 4.1. Profesionalizimi i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit

Evaluimi i jashtëm (esktern) i shkollave në Maqedoninë e Veriut nuk i përmbush funksionet e veta qenësore për të siguruar llogaridhënie të shkollave dhe për t'iu ndihmuar shkollave të përmirësohen. Perceptimi dërmues për evaluimin esktern dhe të brendshëm, siç i është raportuar ekipit për rishikim nga inspektorati, drejtorët dhe arsimtarët ka qenë një proces për sigurim të përputhjes me rregulloret dhe kornizën nacionale për evaluim.

Drejtorja e ISHA-s ka rol vendimtar në formësimin e mënyrës sesi personeli dhe shkollat e kuptojnë rolin e evaluimit të shkollave. Në shumicën e shteteve të OECD-së nga drejtori i inspektoratit pritet të kombinojnë kuptim të thellë të përmirësimit të shkollave, shkathtësi të lidhshme të fuqishëm dhe integritet. Drejtorët e inspektoratit mbajnë poste të larta udhëheqëse në kuadër të sistemit arsimor të shtetit dhe rregullisht e këshillojnë Ministrinë dhe ministrin në lidhje me çështjet e cilësisë së shkollave. Nga ana tjetër drejtori i ISHA-s në Maqedoninë e Veriut nuk konsiderohet post i lartë menaxhues dhe nuk ka rol këshillëdhënës për ministrin. Për shembull kërkesat minimale të përshtatshmërisë për postin e drejtorit janë të ngjashme me ato të inspektorëve tjerë.

Po ashtu ISHA nuk ka kapacitet të mjaftueshëm teknik, integritet dhe pavarësi për ta drejtuar evaluimin e shkollës në nivel nacional. Ekipit shqyrtues i është raportuar se nganjëherë evaluimet e ISHA-s bëhen për qëllime politike, si për shembull për ta justifikuar shkarkimin e drejtorëve. Përpos

çështjes së mungesës së integritetit dhe pavarësisë ekzistojnë edhe disa mekanizma për të siguruar që ISHA të bëhet llogaridhënës për cilësinë e punës së vetë. Në shumicën e shteteve të OECD-së inspektorët e shkollave janë të ngarkuar me një sërë detyrimesh për llogaridhënie, siç është nevoja për të prodhuar raport vjetor të cilësisë së punës së tyre, e cila debatohet publikisht në Parlament. Inspektorët duhet t'i ndjekin kodet e praktikës, madje ekzistojnë

mekanizma të qarta dhe eksplicite për palët përkatëse, siç janë drejtorët, arsimtarët, nxënësit dhe prindërit për të dorëzuar ankesa. Pasi disa nga këto elemente janë prezent në Maqedoninë e Veriut, siç është praktika e raportuar për shfrytëzim të evaluimit me qëllim që të justifikohet shkarkimi i drejtorit, kjo sugjeron që aktualisht sistemi është shumë i dobët.

Tabela 0.9.

Rekomandimet për profesionalizim të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit

4.1.1. Garantimi i varësisë dhe integritetit të Inspektoratit.

Kriteret për emërim të drejtorit të ISHA-s duhet të fokusohen në kompetencat e demonstruara për përmirësim të shkollës dhe fuqizim të kuptimit sesi evaluimi ka ndikim në cilësinë e shkollës. Duhet të fuqizohet aderimi ndaj kodeve nacionale të sjelljes, si dhe duhet të fuqizohet edhe me çdo element të shkeljes, që rezulton me shkarkim.

Rritja e pavarësisë profesionale të ISHA-s do të balancohet me mbikëqyrje më të madhe dhe llogaridhënie për punën e vetë. Të gjitha palët përkatëse

duhet të kenë mundësi të qarta dhe korrekte, me çka do të korrigohet çdo ankesë. Gjithashtu do të mund të formohej një këshill i ekspertëve nacional për arsim, të cilët do të ndihmojnë që të ruhet pavarësia e ISHA-s dhe të mbikëqyret cilësia e punës së vetë. Roli dhe rëndësia e raportit vjetor të ISHA-s mund gjithashtu të fuqizohet duke u fokusuar në mënyrë eksplicite në cilësinë e punës organizative (e jo vetëm të raportohen aktivitetet e realizuara), si dhe të debatohet përmbajtja e tij në Parlament.

Shoqërimi i masave të sipër përmendura me konsultim nacional për ta përcaktuar një vizion të përbashkët "të shkollës së mirë" në Maqedoninë e Veriut do të ndihmonte në zhvillimin e kuptimit dhe pronësisë më të madhe nacionale të rolit

të evaluimit të mbështetjes së përmirësimit të shkollës, gjegjësisht përmirësimit të rezultateve të nxënësve.

4.1.2. Ndërtimi i kapacitetit të ISHA-s.

Aktualisht inspektorët e rinj ndjekin vetëm trajnim fillestar tre ditor, i cili është joadekuat për zhvillim të shkathtësive të nevojshme për evaluim të shkollave në mënyrë të qëndrueshme dhe të vlefshme. Si prioritet i menjëhershëm, ISHA duhet të hartojë dhe ofrojë një pako të kurseve për trajnim të inspektorëve ekzistues, duke u fokusuar në qëllimin e evaluimit të shkollave dhe në zhvillimin e kompetencave kyçe për evaluim, siç është mënyra e kryerjes së observimeve në klasë dhe raportimi në shkolla. Trajnimi duhet t'iu sigurojë inspektorëve mundësi praktike për të provuar





teknika të reja, për të marrë informacion kthyes dhe për të marrë pjesë në vizita për evaluim. Ministria do të duhet që në planin afatmesëm ta rishikojë trajnimin inicial të inspektorëve, me qëllim që ta bëjë atë më në përputhje me kohëzgjatjen, strukturën dhe thellësinë e

programeve të përgatitura në mënyrë të mirëfilltë në shtetet e OECD-së dhe BE-së.

Për ta zgjeruar përmasën dhe thellësinë e përvojës dhe ekspertizës së ISHA-s duhet të konsiderohet trajnimi dhe licencimi i ekspertëve dhe këshilltarëve të jashtëm, të cilët

do të mund t'iu bashkëngjiten ekipeve për evaluim në bazë ad hoc. Si këshilltar potencial të jashtëm mund të përfshihen arsimtarët me përvojë nga shkollat tjera si dhe këshilltarët e BZHA-së dhe Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim (QAPT).

Çështja e politikës 4.2. Përkujdesja që evaluimi integral i shkollës të vë në qendër të fokusit përmirësimin e cilësisë së shkollës

Meqenëse korniza e evaluimit të shkollave të Maqedonisë e Veriut përfshin shumë aspekte të cilat janë të rëndësishme për krijimin e mjedisit efektiv dhe mbështetës të shkollave me 7 fusha, 28 indikatorë dhe 99 parametra, do të ishte vështirë për inspektorët t'i implementojnë dhe vënë shkollat nën presion të madh për t'i përgatitur dhe raportuar të dhënat. Sa më shumë shtete në rrafshin ndërkombëtar e kanë studiuar efikasitetin e praktikave të tyre për evaluim, e kanë parë se është e rëndësishme ta thjeshtësojnë kornizën për t'u fokusuar në aspektet kryesore të cilësisë së shkollave. Kjo është e rëndësishme për ta bartur evaluimin nga ushtrimet me rrethim të përgjigjeve kah rishikimi më i thellë i cilësisë së praktikave shkollore dhe mënyra sesi ato do të mund të përmirësohen.

Një aspekt i veçantë i evaluimit të shkollave në Maqedoninë e Veriut është fakti që nga inspektorët pritet t'i vlerësojnë individualisht të gjithë arsimtarët nëpër shkolla. Meqenëse inspektorët e kanë të kufizuar kohën, observimet individuale të klasave janë zakonisht të shkurtra, vetëm 10 minuta, gjatë së cilave inspektorët vetëm se do t'i kontrollojnë dokumentet, siç janë portofolat e

nxënësve dhe planet mësimore. Arsimtarëve nuk i jepet informacion kthyes me shkrim, si dhe nuk i prezantohen rezultatet e observimit të orëve mësimore.

Nëse evaluimet e shkollave shpijnë drejt përmirësimi, ato duhet t'iu ofrojnë shkollave informacione të cilat do t'iu ndihmojnë atyre ta kuptojnë se çka bëjnë mirë dhe ku mund të bëhen përmirësime. Edhe pse tani intervistat e ekipit shqyrtues kanë zbuluar se shkollat në masë të madhe e perceptojnë evaluimin si një proces të imponuar nga jashtë, i cili nuk ka të bëjë me planet dhe përpjekjet e tyre për zhvillim. Një mënyrë e rëndësishme për të siguruar që vlerësimet të nxisin veprim të shkollave është dhënia e informacioneve kthyes të dobishme dhe vepruese në fund të vlerësimit, duke i plotësuar ato me mbështetje më të madhe vijuese aty ku është e nevojshme.




Tabela 0.10.

Rekomandimet për fokusim të evaluimit integral të shkollave në favor të përmirësimit të cilësisë

4.2.1. Revidoni evaluimin integral të shkollave për t'iu përqendruar më tepër në cilësinë e mësimdhënies dhe mësim. Korniza e Indikatorëve të cilësisë së suksesit të shkollave (ICSSH/SPQI), të cilat e drejtojnë evaluimin duhet të reduktohen në rreth 10 deri në 15 dhe të revidohen me qëllim që të bëhet dallim ndërmjet strukturës së indikatorëve, që duhet të evakohen në çdo cikël, si dhe të indikatorëve sekondarë që duhet vlerësuar mbi bazë të rotacionit/diskrecionit. Kjo do ta bëjë më të menaxhueshme kornizën për ekipet e inspektimit dhe do t'iu mundësojë atyre të fokusohen në indikatorët kryesorë të mësimdhënies dhe mësim. Po ashtu ekzistojnë boshllëqe në kornizën ekzistuese, të cilat duhet të trajtohen. Për shembull, indikatorët për lidhshirin pedagogjik të shkollave, cilësia e vetëevaluimit të kapacitetit

të shkollave për të reflektuar në praktikata e veta duhet të përfshihet si pjesë e indikatorëve kryesorë të vlerësuar nga ISHA.

Për të krijuar më shumë kohë për vlerësim kuptimplotë të evaluimit të mësimdhënies dhe mësim, vlerësimi individual i arsimtarëve, të cilët aktualisht janë pjesë e vlerësimit integral, duhet të zëvendësohen me observime më të zgjeruara të klasave, gjegjësisht klasave mostër, me qëllim që të arrihet kuptim më thellë të udhëzimeve në shkollë. Në vend të kësaj vlerësimi individual i arsimtarëve duhet të bëhet nga drejtorët e shkollave dhe BZHA-ja (Rekomandimi 3.2.1). Për ta zvogëluar ngarkesën administrative të vënies së evaluimit integral në shkolla, ISHA duhet ta thjeshtësojë dhe digjitalizojë koleksionin e të dhënave administrative.

4.2.2. Përkujdesuni që evaluimi integral të ofrojë informacion kthyes për shkollat. ISHA duhet të përkujdeset që rekomandimet në raportet për evaluim të shkollave të jenë të qarta, specifike dhe vepruese. ISHA mund të fillojë me rishikimin e mostrës së raportit shtetëror dhe intervistimin e shkollave për

ta kuptuar mënyrën e përdorimit të informacionit kthyes. Po ashtu duhet të fokusohet në praktikata ndërkombëtare të raportimit. Shkollat me sukses të ulët me shumë gjasa do të kenë nevojë për ndihmë shtesë për të vepruar në raport me informacionin kthyes, ndërsa Ministria duhet të zbulojë mënyra për ta përqendruar mbështetjen e jashtme, ku do të mund ta bëjë dallimin më të madh. Në këtë drejtim shteti duhet ta shqyrtojë mundësinë që gradualisht ta përfshijë qasjen e bazuar në rrezik për evaluimin e shkollave, si dhe të vijojë t'iu jep prioritet shkollave, të cilat përballen me rrezik për indikatorët kryesorë. Si pjesë e këtij modeli të ri vizitat e mëtejme të inspektorëve në të gjitha shkollat do të mund të zëvendësohen me mbështetje më të qëndrueshme për shkollat përkatëse, që udhëhiqet nga niveli rajonal ose komunal. Maqedonia e Veriut do të duhet ta shqyrtojë strukturën më të mirë për të ofruar mbështetje të tillë, si për shembull, nëse duhet të krijohet një organ i zyrtarëve për përmirësim të shkollave, i cili do të punojë në më shumë komuna ose do të zhvillojë njësi të posaçme në kuadër të ISHA-s.

Çështja e politikës 4.3. Zhvillimi i kapaciteteve të shkollave për të realizuar vetëevaluim kuptimplotë

Ndonëse shumica e shkollave në Maqedoninë e Veriut kryejnë vetëevaluim të rregullt dhe zhvillojnë plane shkollore për veprim, megjithatë pak sosh i kanë përvetësuar këto procese si vegla të brendshme për përmirësim të cilësisë së praktikave të tyre. Aktualisht protagonistët e shkollave me rol drejtues në vetëevaluim nuk pranojnë ndonjë trajnim ose udhëzim për implementim të procesit të vetëevaluimit efektiv, i cili është i ngërthyer në aktivitetet e shkollës për planifikim.

Njëkohësisht drejtorët e shkollave në Maqedoninë e Veriut nuk janë sa duhet të trajnuar për të kryer detyra pedagogjike të lidhshme, siç është drejtimi i aktiviteteve për vetëevaluim dhe planifikim, ose përcaktimi i vizionit të qartë për shkollën. Kohëzgjatja e limituar (192 orë) dhe natyra teorike e trajnimit inicial për drejtorë nuk ofron kohë për përgatitje në këto sfera. Edhe pasi të emërohen në postin e drejtorëve, përsëri ka programe të limituara për zhvillim të tyre profesional. Përveç kësaj, ndërhyrjet politike dhe niveli i lartë i ndërrimit të drejtorëve e bën të pamundshme të krijohen profile profesionale të drejtorëve të shkollave, të cilët janë të njohur për ekspertizë.

Tabela 0.11.

Rekomandimet për zhvillim të kapacitetit të shkollave

4.3.1. Ofroni mbështetje dhe trajnim për protagonistët e shkollave për vetëevaluim, duke i konsideruar këto veprime:

- ▶ Të rishikohet udhëzuesit për vetëevaluim. Si hap i parë vetë shteti mund ta rishikojë përvojën e shkollave për vetëevaluim, në mënyrë që ta kuptojë se çfarë çfarë duhet të përfshijë një manual i ri i vetëvlerësimit gjithëpërfshirës.
- ▶ Të ofrohet më shumë trajnim për protagonistët e

shkollave për vetëevaluim. Moduli i detyrueshëm praktik për vetëevaluim do të mund të shtohet në përgatitjen iniciale të drejtorëve të shkollave. Duhet të ofrohet trajnim i rregullt për personelin dhe këshillin e shkollës të përfshirë në vetëevaluim. Këshilltarët e BZHA-së do të mund t'iu ofrojnë ndihmë teknike shkollave që kanë më shumë vështirësi për të bërë vetëevaluim kuptimplotë.

- ▶ Të rishikohen dhe ofrohen informacione kthyes për vetëevaluim gjatë evaluimit integral, duke shtuar një indikator të cilësisë së praktikave të vetëevaluimit në kornizën integrale të evaluimit.
- ▶ Të krijohet portal në internet, shkollat do t'i shkëmbejnë

përvojat e tyre në vetëevaluim. Ministria po ashtu mund t'i njeh shkollat me praktika të jashtëzakonshme për vetëevaluim, përmes titullit "organizatat për mësim" ose "përsosmëria në përdorimin e dëshmimeve" si dhe t'i shkëmbejë shembujt e praktikës së mirë në portalin e internetit.

4.3.2. Zhvillimi i shkathtësive për lidhshme të drejtorëve të shkollave. Maqedonia e Veriut duhet të konsiderojë të krijojë një akademi për lidhshme, përmes së cilës do të ndihmojë në profesionalizimin e rolit të drejtorëve. Kjo akademi do të jetë përgjegjëse për të ofruar përgatitje iniciale dhe zhvillim profesional të drejtorëve në



kuadër të punës së tyre. Fillimisht akademia duhet ta koordinojë finalizimin dhe prezantimin e standardeve të kompetencës për drejtorët, gjë që do të përdoret për definim të përzgjedhjes dhe trajnimit të tyre, si dhe evaluim të lidhshirë të shkollës gjatë evaluimit të saj.

Mbrojtja e procesit të emërimit të drejtorëve nga ndërhyrje politike do të jetë me rëndësi

qenësore në drejtim të sigurimit që drejtorët të përzgjedhen në bazë të kompetencës së tyre profesionale. Ndër mënyrat për ta arritur këtë është sigurimi i udhëzimeve për këshillat e shkollave dhe përfundimi i rolit të komunave në verifikimin e emërimeve dhe rizgjedhjeve të drejtorëve. Procesi i verifikimit nga komunat duhet të ndërrohet me verifikimin nga një këshill i

jashtëm dhe i pavarur, siç është ISHA. Vendimet në lidhje me rizgjedhjen dhe shkarkimin e drejtorëve duhet gjithashtu të depolitizohen përmes përfshirjes së vlerësimit të suksesit të punës së drejtorëve, me qëllim që të fitohet masë e drejtë dhe e pavarur për vlerësim të suksesit të punës.

Çështja e politikës 4.4.

Furnizimi i shkollave me resurse më të mëdha, me qëllim që të avancohet cilësia dhe ndikimi i vlerësimit të shkollës

Shkollat në Maqedoninë e Veriut do të kenë nevojë për resurse plotësues për evaluim përkatës, si mjete për menaxhim të mëtejshëm të tyre. Qasja më e mirë në të vetë të dhënat e tyre do t'iu mundësojë shkollave ta analizojnë dhe monitorojnë suksesin e tyre dhe ta krahasojnë veten me të tjerët. Shumë shtete përdorin vlerësim të standardizuar dhe kontrollim të rezultateve për të bërë evaluim të duhur të shkollës. Korniza e ICSSH-së së Maqedonisë së Veriut përfshin pak indikatorë për rezultatet e mësimin të nxënësve, duke i kufizuar kapacitetet e shkollave dhe inspektoratit për evaluim të përmesës së rezultatet mësimore në një shkollë përkatëse qëndrojnë në raport me vlerat nacionale dhe lokale.

Pos kësaj shkollat kanë nevojë për resurse të parapara adekuate dhe financiare për të përfshirë përmirësime të cilësisë. Përndryshe shkollat në Maqedoninë e Veriut kanë autoritet të rëndësishëm diskrecional në lidhje me përdorimin e resurseve të tyre, dekadat e financimit të ulët dhe mungesa e transparencës së distribuimit të resurseve financiare nënkupton që ata kanë pak resurse financiare për t'i implementuar planet për përmirësim. Transparenca më e madhe për financim adekuat do të duhet të plotësohet përmes rritjes së përgjithshme të financimit të shkollave.

Tabela 0.12.

Rekomandime për zhvillim të resurseve të shkollave që kanë të bëjnë me evaluimin

4.4.1. Furnizoni shkollat me indikatorë dhe mjete për matje të suksesit të tyre, për shembull duke përdorë rezultatet e maturës shtetërore si masë për rezultatet e mësimit të nxënësve në kornizën për evaluim të shkollës. Ministria duhet gjithashtu t'i bëjë të dhënat më të qasshme për shkollat, në mënyrë që ata të mund t'i monitorojnë indikatorët kryesorë të rezultateve, siç janë rezultatet e mësimit të nxënësve, si dhe shkallën e përfundimit ose braktisjes së shkollës. Një mundësi është të zhvillohet një portal i shkollës, ose "dritare" në EMIS, e cila do të ofrojë qasje individuale të shkollave për të dhënat e tyre, por edhe do të

sigurojë vlerat nacionale dhe rajonale.

Planet e Maqedonisë së Veriut për përfshirje të vlerësimit nacional janë shumë pozitive dhe do të ofrojnë të dhëna esenciale për monitorim të rezultateve të mësimit në nivel nacional (shih Çështja e politikës 5.2). Sidoqoftë duhet të rishqyrtohet synimi për përdorim të rezultateve për kategorizim të shkollave. Përdorimi i rezultateve të vlerësimit vetëm për t'i kategorizuar shkollat dhe për të shpërblyer ndonjë arsimtar është veprim jo korrekt dhe si i tillë nuk e kontrollon profilin socio-ekonomik të shkollës. Në vend të kësaj rezultatet e vlerësimit do të mund të përfshihen në kornizën e shkollës për evaluim për t'i inkurajuar shkollat të reflektojnë për mënyrën sesi i mbështesin rezultatet mësimore të nxënësve dhe llogaridhënien e shkollës. Në planin afatmesëm

ministria mund të konsiderojë ta zhvillojë indeksin e shkollës, i cili e kontekstualizon suksesin e shkollës, duke përfshirë faktorët tjerë siç është kontributi financiar dhe konteksti socio-ekonomik.

4.4.2. Sigurojuni shkollave resurse adekuate financiare për implemmentim të planeve të tyre për përmirësim.

Ministria duhet të konsiderojë ta bëjë të detyrueshme për komunat përdorimin e formulave të financimit dhe të ofrojë udhëzime të qarta për variablat e përfshira (p.sh. urban/rural, rrethi socio-ekonomik i nxënësve). Ministria duhet gjithashtu ta shqyrtojë mundësinë që t'iu jep në dispozicion shkollave grante të vogla, të ndara nga mjetet financiare qendrore, me qëllim që të financohet zhvillim profesional ose implementimi i projekteve në kuadër të planit të tyre për përmirësim.



5. Krijimi i kornizës më të fuqishme për monitorim dhe vlerësim të progresit nacional në arsim



Evaluimi sistemor është me rëndësi qenësore për reformat në arsim. Ky evaluim është i rëndësishëm për llogaridhënie të qeverisë dhe palëve tjera përkatëse, në lidhje me përmbushjen e qëllimeve nacionale arsimore. Po ashtu evaluimi i siguron informacionet e nevojshme për t'i definuar më mirë politikat dhe për t'u siguruar se ato e kanë arritur ndikimin e synuar. Sistemi i evaluimit në Maqedoninë e Veriut është në fazë të hershme të zhvillimit. Viteve të fundit janë vërejtur disa hapa drejt themelimit të institucioneve dhe instrumenteve, të cilat mund ta mbështesin evaluimin e sistemit. Sidoqoftë ende mungojnë shumë komponentë themelore, ndërsa sistemet e të dhënave dhe proceset për sigurim të informacioneve në suaza të vendimmarrjes janë të dobëta. Në mesin e boshllëqeve të rëndësishëm janë mungesa e qëllimeve të qarta për përmirësim të rezultateve të mësimit dhe vlerësimit shtetëror, të cilat do t'i mbështesnin përpjekjet për t'i avancuar të arriturat.

Çështja e politikës 5.1. Centralizimi i përdorimit të sistemit EMIS dhe përmirësimi i kapaciteteve të tij

Sistemi për Menaxhim të Informacioneve për Arsim (EMIS) në Maqedoninë e Veriut nuk përdoret plotësisht nga hartuesit e politikave në nivel të shtetit. Për shembull, pjesa e MASH-it përgjegjëse për arsim fillor dhe të mesëm drejtpërsëdrejti i grumbullon të dhëna nga shkollat, në vend se t'i merr ato nga sistemi EMIS. Ofrimi i të dhënave për

më shumë kërkues është barrë për shkollat, madje ekzistimi i më shumë koleksioneve të të dhënave e rrezikon komprometimin e cilësisë së tyre.

Kjo situatë reflekton një numër të sfidave në sistemin e tanishëm operativ EMIS. Fillimisht me vetëm dy anëtarë të personelit, ekipi i EMIS-it ka mungesë të kapaciteteve dhe i mungon zëri i fuqishëm brenda MASH-it. EMIS-i po ashtu nuk ka mekanizëm të fuqishëm për kontroll të cilësisë, siç janë të dhënat për verifikim dhe procedurat për të siguruar se të dhënat janë të cilësisë së lartë. Çështje tjetër është fakti që të dhënat futen në baza të ndryshme të të dhënave, të cilat nuk janë të ndërlidhura mes vete, me çka kufizohet analiza e të dhënave. Për shembull, të dhënat demografike të nxënësve futen në EMIS, ndërsa rezultatet e maturës futen në bazën e të dhënave QSHP. Funksionaliteti i EMIS-it është gjithashtu aktualisht i kufizuar, gjë që nënkupton se përdoruesit nuk janë në gjendje të përfitojnë maksimalisht nga këto të dhëna.

Përveç kësaj aktualisht EMIS luan rol të kufizuar në monitorimin e qëllimeve nacionale, që paraqet aspekt të rëndësishëm të evaluimit të sistemit. Kjo e reflekton mungesën e qëllimeve të matshme nacionale në Maqedoninë e Veriut. Përderisa Strategjia Gjithëpërfshirëse për Arsim 2018 -2025 në vend i numëron disa objektiva nacionale, megjithatë ato nuk janë të fokusuar në rezultate, në veçanti jo në përmirësimin e mësimit të nxënësve, madje nuk janë as të matshme.

Tabela 0.13.

Rekomandime për përmirësim të përdorimit të EMIS-it

5.1.1. Formalizoni EMIS-in si bazë qendrore e të dhënave. Ministria duhet ta konsiderojë bartjen e Njesisë për EMIS më afër udhëheqjes së drejtpërdrejtë të ministrisë, me qëllim që t'i jepet asaj autoritet ndaj grumbullimit të të dhënave në nivel të shkollës. Gjithashtu duhet të përforcohen kapacitetet e personelit në Njesisë për EMIS, duke angazhuar më shumë persona dhe duke iu adresuar mangësive aktuale të shkathtësive dhe kuadrove të lidershit të fuqishëm, zhvillimit të softuerit dhe analizës cilësore.

Krijimi i protokolleve për përkufizim dhe grumbullim të të dhënave do të ndihmonte në qartësimin e rregullit se kujt duhet shkollat t'ia dorëzojnë të dhënat dhe të sigurohet që të zbatohen përkufizimet standarde të të dhënave nëpër shkollat e ndryshme dhe në sistemin e përgjithshëm arsimor. Po ashtu shteti duhet ta shqyrtojë mundësinë e përdorimit të identifikimeve nacionale të nxënësve në të gjitha bazat e veta të të dhënave dhe të sigurojë që të gjitha të dhënat të

digjitalizohen, që të mundësohet bashkëveprim më i madh ndërmjet bazës së të dhënave, në veçanti pasi që edhe baza e të dhënave EMIS edhe QSHP-ja i përmbajnë rezultatet e maturës. Përfundimisht përfshirja procedurave për sigurim të cilësisë së rregullt për të dhënat EMIS (p.sh. vizita e mostrave të shkollave për kontrollim të koleksioneve të të dhënave), do të ndihmonte në verifikimin e saktësisë së të dhënave dhe për inkurajim të përdorimit më të shpeshtë individual të sistemit.

5.1.2. Fuqizimi i funksionalitetit të EMIS duke përfshirë procedurat e rregullta të raportimit për t'iu ndihmuar përdoruesve të sistemit EMIS, që ta avancojnë përdorimin e të dhënave të sistemit. Për shembull, do të mund të publikohen raportet e rregullta të të dhënave që përdoren më së shumti (p.sh. në lidhje më pjesëmarrjen dhe përfundimin). Në këtë mënyrë përdoruesit të mund automatikisht t'i rimarrin të dhënat. Zhvillimi portaleve të të dhënave publike të lehta për përdoruesit do t'iu mundësojnë përdoruesve siç janë shkollat, hulumtuesit dhe hartuesit nacional të politikave për të kërkuar të dhëna nacionale për arsim dhe për zgjedhje të shkollave dhe komunave për të bërë analiza krahasimtare (p.sh.

në bazë të lokacionit ose gjuhës së mësimdhënies).

5.1.3. Përmirësimi dhe artikulimi i qëllimeve nacionale për arsim dhe harmonizim me zhvillimet e mëtejme të sistemit EMIS.

Për ta ndihmuar shtetin drejt prioriteteve nacionale, qeveria do të duhet të përcaktojë qëllime specifike për përmirësimin e të arriturave të nxënësve, të ndërlidhura me synime të matshme dhe të arritshme. Synimet do të mund të bazohen në të dhënat e vlerësimit ndërkombëtar (p.sh. reduktimi i kategorisë së nxënësve me sukses të ulët në PISA në përputhje me caqet e Bashkimit Evropian) dhe vlerësimin nacional kur të zhvillohet ai. Kur merren parasysh dëshmitë e dispariteteve në rezultatet e mësimit, do të mund të përfshihen edhe qëllimet tjera për përmirësim të barazisë, siç është mbyllja e diferencës ndërmjet mjediseve urbane dhe rurale dhe/ose grupeve të ndryshme etnike. Qëllimet dhe caqet tjera do të duhet të shoqërohen përmes zhvillimit të indikatorit të kornizës nacionale për grumbullim të të dhënave dhe monitorim publik të progresit. Zhvillimi i kornizës së indikatorit do të ndihmojë në orientimin e zhvillimit të ardhshëm të EMIS-it përmes identifikimit të lehtë të boshllëqeve të të dhënave.

Çështja e politikës 5.2. Hartimi i testimit nacional mbështetës të qëllimeve nacionale mësimore

Nga vitit 2013 deri në vitin 2017 Maqedonia e Veriut ka realizuar testim nacional të standardizuar, qëllimi i së cilit ka qenë që të krahasohen notat e dhëna nga arsimtarët me rezultatet e nxënësve në teste. Ideja ka qenë që arsimtarët të kategorizohen në bazë të asaj sesa ka qenë e përafërt nota e tyre me rezultatet e testit të nxënësve, ashtu që arsimtarëve më të suksesshëm në këtë radhitje iu jepej shpërblim financiar. Sidoqoftë ky sistem i shpërblimit asnjëherë nuk është implementuar ndërsa testimi është anuluar, kryesisht për shkak se ka bërë shumë presion ndaj arsimtarëve dhe ka pasur ndikim negativ në aktivitetet e tyre në klasë.

Tani Maqedonia e Veriut planifikon të përfshijë një vlerësim të ri nacional. Si vlerësim i hartuar mirëfilli, ky lloj i testimit do të ofronte informacione të vlefshme për ta monitoruara suksesin e nxënësve në shkollët kyçe të arsimit të tyre në raport me qëllimet shtetërore. Rezultatet mund edhe të përdoren për të përfshirë politika dhe sistem të ardhshëm të planifikimit, por edhe të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së gjyqimeve profesionale të arsimtarëve në nivel të klasës (shih Rekomandimet 3.3.1 dhe 3.3.2). Përveç kësaj Ministria e ka konsideruar përdorimin potencial të rezultateve për kategorizimin dhe

shpërblim të shkollave. Sidoqoftë një masë e tillë do të mund ta cenojë funksionin formues të notimit dhe të ketë ndikim negativ në sjelljen e arsimtarit dhe shkollës. Përveç kësaj rezultatet janë të ndikuara nga një spektër i gjerë i faktorëve përtej kontrollit të shkollës, siç është sfondi i nxënësve, aftësia dhe motivi i tyre (OECD, 2013). Kjo nënkupton se radhitja e shkollave vetëm në bazë të rezultateve të vlerësimit nuk do të ofrojë masa të sakta për suksesin e shkollës. Për këtë arsye rishikimi rekomandon që Maqedonia e Veriut nuk duhet t'i përdor rezultatet e vlerësimit për radhitje dhe shpërblim të shkollave (shih Rekomandimi 4.4.1).



Tabela 0.14.

Rekomandime
për testim të ri
nacional

5.2.1. Caktoni qëllimin e testimit nacional dhe harmonizoni strukturën e tij me qëllimin.

Ministria duhet fillimisht të krijojë një këshill drejtues për të marrë vendime kryesore për zhvillimin e testimit dhe ndërtimin e mbështetjes nacionale. Këshilli drejtues do të mund të ndihmojë për të përcaktuar se cila organizatë do të jetë përgjegjëse për testimin e ri. Duke pasur parasysh përvojën e QSHP-së në administrimin e maturës dhe vlerësimin nacional, më së miri është që QSHP-së t'i jepet kjo përgjegjësi. Më tej këshilli do të duhet ta përcaktojë funksionin primar të testimit (vlerësimin). Ky rishikim rekomandon se kjo e fundit do të jetë e fokusuar në ofrimin e informacionit formuese të arsimtarëve dhe shkollave për të ndihmuar në adresimin e sfidave kryesore në shtet, siç janë rezultatet e ulëta për mësim dhe mbështetja e vogël për kapacitetin e arsimtarët për notim (shih Çështja e politikës 2.2), përpos monitorimit të rezultateve mësimore në nivel të sistemit.

Pasi që të përcaktohet qëllimi parësor i vlerësimin, ai duhet të ndikojë për së afërmi në hartimin e strukturës së tij. Pikët vijuese sugjerojnë për mënyrën sesi do të mund të hartohet më së miri mbështetja e qëllimit primar të notimit formues:

- ▶ Kombinoni regjistrimin (p.sh. të gjithë strukturën e nxënësve) dhe testimin e bazuar në mostër (p.sh. mostra reprezentative e nxënësve). Vlerësimi i regjistrimit do të mund të ofrojë informacion formues për t'iu ndihmuar arsimtarëve të përshtatin udhëzime për nevojat e nxënësve të tyre. Sidoqoftë regjistrimi i vlerësimeve do të mund lehtë të ekspozohet në rrezik të madh, madje është i shtrenjtë dhe merr kohë për implementim. Për t'i menaxhuar këto shpenzime, Maqedonia e Veriut mund të implementojë një model hibrid të vlerësimeve të regjistrimit në klasat III dhe VI, ashtu që mbështetja do të mund të orientohet drejt nxënësve dhe shkollave që kanë vështirësi; dhe testimin e bazuar në klasën IX për të shmangur konfuzionin e vlerësimin nacional me provimin pranues të shkollave të mesme.

- ▶ Testoni gjuhën amtare dhe matematikën pasi që ato i prezantojnë shkathtësitë bazë. Lëndët tjera, p.sh. shkencë dhe/ose historia kombëtare do të mund të shtohet në klasën IX.

- ▶ Përkujdesuni që pyetjet të shërbejnë për vlerësim të mësimin, e jo memorizimin Ndiqni pyetjet adekuate – rregullat e drejtshkrimit (p.sh. rishikimi i pyetjeve për anim të mundshëm dhe ndryshimi e vendit të përgjigjeve me më shumë zgjedhje, ku vetëm njëra është përgjigje e gabuar. (Anderson and Morgan, 2008[34].). Përgjigjeve me më shumë zgjedhje dhe përgjigjet e mbyllura do të mund

të përdoren në klasat III dhe VI, ndërsa pyetjet e tipit të hapur shtohen për nxënësit e klasës IX.

- ▶ Konsideroni mundësinë që testimet të bëhen përmes kompjuteri, për shkak se është më lirë të administrohet (përpos investimit kapital në fillim), më pak ka mundësi të ekspozohet në gabimet njerëzore, ndërsa rezultatet fitohen shumë më shpejt.

5.2.2. Vini kujdes të veçantë në përhapjen dhe përdorimin e rezultateve të vlerësimin nacional për avancim të vlerës të tyre formuese. Raporte të ndryshme do të mund të zhvillohen për shkolla dhe arsimtarë të caktuar, si dhe një raport publik nacional. Secili raport duhet të përmbajë informacione për të ndihmuar përdorimin e informacioneve të audiencës së posaçme për ta kuptuar suksesin aktual dhe për të bërë përmirësime në të ardhmen. Për shembull, raportet për arsimtarët do të mund të përfshijnë analizë në nivel të pyetjeve për t'iu ndihmuar atyre ta përmirësojnë mësimdhënien dhe vlerësimin e përmbajtjes së ngjashme në të ardhmen. Raporti nacional duhet t'i ndajë rezultatet në bazë të faktorëve demografik (p.sh. gjinia, gjuha e mësimdhënies, tipi i shkollës, komuna, statusi socio-ekonomik) për të përcaktuar zhvillim të politikës.

Çështja e politikës 5.3. Institucionalizimi i sistemit të evaluimit

Hartimi i politikave për arsim duhet t'i shfrytëzojë informacionet nacionale, në lidhje me mënyrën sesi aktualisht funksionon sistemi, si dhe hulumtimet ndërkombëtare në lidhje me faktorët, që kanë kontribuar në efikasitetin e mësimdhënies dhe mësimi. Megjithatë në Maqedoninë e Veriut marrja e vendimeve nuk është gjithnjë e bazuar në dëshmitë e disponueshme, madje rrezikohet që qasjet politike të kenë prioritet ndaj asaj që është më me rëndësi për mësimdhënie dhe mësim. Kjo do të nënkuptojë që resurset e kufizuara të sistemit nuk përdoren me efikasitetin e duhur, për shembull numri i arsimtarëve është rritur vazhdimisht në dekadat e fundit pavarësisht nga zvogëlimi i numrit të nxënësve (shih Çështja e politikës 3.1). Po ashtu kjo mund të rezultojë në politika me pasoja negative për mësimdhënie dhe mësim, siç ka qenë qëllimi për përdorim të rezultateve të të testimit paraprake nacional, me qëllim që të shpërblehen ose dënohen arsimtarët (shih Çështja e politikës 5.2).



Zhvillimi i politikave në arsim duhet të bazohet në hulumtime dhe dëshmi

Kjo situatë i reflekton kapacitetet e kufizuara analitike në kuadër të qeverisë qendrore.

Njëkohësisht edhe pse agjencitë rreth ministrisë, siç janë BZHA-ja, QSHP-ja dhe ISHA kanë ca përgjegjësi hulumtuese, megjithatë ato kanë mangësi për ta qartësuar mandatet, resurset, kapacitetet dhe liderhipin e qëndrueshëm. Çështje tjetër është se informacionet arsimore nuk janë sa duhet të raportuara ose analizuara publikisht. Për dallim nga shumica e shteteve të OECD-së, Maqedonia e Veriut nuk ka raport nacional arsimor, i cili udhëhiqet nga qëllimet e politikës dhe prioritetet nacionale.

Monitorimi dhe evaluimi i sistemit është gjithashtu i dobishëm në nivel lokal. Pas decentralizimit, komunat kanë marrë përsipër përgjegjësinë për ndarjen e resurseve të shkollave dhe rekrutimin e personelit, por kjo nuk është shoqëruar nga rritja e mbikëqyrjes. Përvoja e decentralizimit në shtetet tjera pasqyron se me qëllim që të arrihen rezultate më të mira, pushtetet vendore duhet ta ndjekin një kornizë dhe të bëhen llogaridhënës. (World Bank, Keeping an eye on subnational governments: internal control and audit at local levels, 2006). Gjithashtu komunat nuk janë sa duhet të furnizuara me resurse për menaxhim të procesit arsimor. Secili pushtet vendor ka nga një ose dy nëpunës për çështjet arsimore. Ekipit realizues të këtij shqyrtimi i është raportuar se komunat nuk afrohen me qëllim që t'i ndajnë me të tjerët praktikatat dhe përvojat e mira.



Tabela 0.15.

Rekomandimet
për
institucionalizim
të sistemit të
evaluimit

5.3.1. Ndërtimi i mbështetjes për evaluim të sistemit përmes krijimit të analizë së politikës dhe njësisë për hulumtim brenda MASH-it. Ky rishikim fuqishëm e mbështet iniciativën aktuale të MASH-it për ta zhvilluar njësinë e saj, e cila do të ndihmojë që informacionet të përdoren në mënyrë më sistematike me qëllim të hartimit të politikave. Me qëllim që njësia e re të udhëzojë segmente të ndryshme të MASH-it dhe të institucioneve të saja të përafërta, ajo duhet medoemos të vendoset në Ministri (p.sh. duke i raportuar drejtpërsëdrejti ministrit dhe duke marrë pjesë në takime të rregullta me leadershipin e Ministrisë).

5.3.2. Zhvillimi i rrjetit më të gjerë të njëjve hulumtuese, të cilat kontribuojnë në sistemin e evaluimit. Për t'i përmbushur detyrat e tyre agjencitë e specializuara, siç janë BZHA-ja, QSHP-ja dhe ISHA, duhet t'i definojnë qartë rolet, të cilat nuk ndryshojnë në raport me qasjet politike. Kjo mund të mbështet duke zhvilluar mandate për secilën agjenci, e cila është e përcaktuar me ligj, duke u marrë vesh për një aktivitet programor shumëvjeçar dhe buxhet

përkatës për secilën agjenci, me qëllim që të sigurohen kompetencat teknike dhe profesionale të kandidatëve.

Funksioni i hulumtimit të agjencive individuale duhet të shqyrtohet me kujdes. BZHA-ja duhet të formalizohet dhe profilizohet si krah hulumtues i qeverisë. Ajo duhet të furnizohet me resurset e domosdoshme dhe të merr përsipër përgjegjësitë përkatëse, si pjesë e fuqizimit më të gjerë të rolit të saj në mbështetje të përmirësimit të mësimdhënies (shih Rekomandimi 3.3.3). Duke pasur parasysh informacionet e shumta, të cilat i grumbullojnë QSHP-ja dhe ISHA, të dy agjencitë do të duhet të vazhdojnë të kenë funksione komplementare të hulumtimit me resurset e domosdoshme dhe personel të aftë, për përmbushjen e detyrave.

5.3.3. Promovimi i shkëmbimit dhe përdorimit të rezultateve të evaluimit, përmes publikimit vjetor të një raporti analitik, publik dhe arsimor për ta mbajtur qeverinë përgjegjëse për përmirësimin e arsimit. Raporti mund të përfshijë pasqyrim të shquar në raport me qëllimet dhe caqet nacionale, të shoqëruar me analizë të progresit. Po ashtu këto raporte mund të përdoren nga bashkësia e gjerë hulumtuese për të drejtuar analizën sekondare në çështjet kyçe, të cilat kanë ndikim në sistemin arsimor.

Masa tjetër për të mundësuar që shqyrtimi i dëshmimeve jopartiake të bëhet pjesë integrale e procesit të politik-bërjes, do të mund të jetë prezantimi i udhëzimit qeveritar, sipas së cilit të gjitha politikat dhe programet qeveritare duhet fillimisht të pilotohen, pastaj të studiohet pilotimi para se të bëhet implementimi i plotë i tij. Programet më të mëdha duhet të vlerësohen në mënyrë sistematike, me qëllim që të përcaktohet efikasiteti i tyre dhe të strukturohen reformat e ardhme.

5.3.4. Fuqizimi i llogaridhënies lokale. Qeveria e Maqedonisë e Veriut duhet ta shqyrtojë përcaktimin e pritjeve të qarta për mënyrën sesi nga komunat pritet ta përmbushin rolin e tyre në realizimin e arsimit (p.sh. duke i përcaktuar parimet për financim ose ekipim të shkollave publike). Këto parime duhet gjithashtu të sigurojnë bazë për revizion lokal. Duke pasur parasysh paqartësinë e tanishme të aranzhimeve të financimit të shkollave në nivel lokal dhe dëshminë se financimi i tanishëm nuk është efikas, vendi duhet të vlerësojë dhënie e resurseve për arsim dhe t'i përdorë rezultatet për të nisur zhvillimin e një politike më efektive të shpërndarjes së burimeve (shih po ashtu Rekomandimin 4.4.2).

Referencat

- Baza e të dhënave Eurostat - Eurostat*
- Eurostat 2017 *Employment rates of recent graduates (aged 20–34) not in education and training, 2017*
- OECD2015 *Education at a Glance 2015: OECD Indicators*
- OECD2017 *Education at a Glance 2017: OECD Indicators* OECD Publishing, Paris
- OECD2018 *Education at a Glance 2018: OECD Indicators*
- OECD2016PISA 2015 Results (Volume I): Excellence and Equity in Education OECD Publishing, Paris
- OECD2016PISA 2015 Results (Volume II): Policies and Practices for Successful Schools OECD Publishing, Paris
- OECD2003 *Reviews of National Policies for Education: South Eastern Europe 2003 : Volume 1: Albania, Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Croatia, Kosovo* OECD Publishing, Paris
- OECD2013 *Synergies for Better Learning: An International Perspective on Evaluation and Assessment* OECD Publishing, Paris
- OECDUNICEF2018 *OECD-UNICEF survey of teachers and principals in North Macedonia*
- Ofqual2012 *International Comparisons in Senior Secondary Assessment: Full Report* Ofqual
- Policy and Practice Analysis of the Teacher Professional and Career Development in the Republic of Macedonia* 2013 USAID, Shkup
- 2015 *Schools for 21st-Century Learners: Strong Leaders, Confident Teachers, Innovative Approaches* OECD Publishing, Paris
- Teaching Excellence through Professional Learning and Policy Reform: Lessons from Around the World* 2016 OECD
- Teaching Excellence through Professional Learning and Policy Reform: Lessons from Around the World* 2016 OECD
- UNESCO-IBE2011 *World Data on Education - The former Yugoslav Republic of Macedonia*
- UNESCO-UIS2018 *Education : Initial government funding of education per student as a percentage of GDP per capita* Mendeley
- UNESCO-UIS *The Republic of North Macedonia | UNESCO UIS* Mendeley
- USAID *Main findings and recommendations from the nationwide assessment of reading and numeracy skills in early grade students*
- World Bank 2006 *Keeping an eye on subnational governments: internal control and audit at local levels* World Bank, Uashington.
- World Bank forthcoming *North Macedonia: Public Finance Review* World Bank, Uashington

